



SHËRBIMI SOCIAL



# RAPORT VJETOR 2025

Janar  
2026

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

### **Përmbledhje**

|      |                                                        |    |
|------|--------------------------------------------------------|----|
| I.   | Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ..... | 1  |
| II.  | Drejtoria e Komisionimit të PAK.....                   | 15 |
| III. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale.....                    | 18 |
| IV.  | Drejtoria e Financës dhe Statistikës .....             | 30 |
| V.   | Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme .....              | 40 |

## **PËRMBLEDHJE**

Ky raport pasqyron në mënyrë të plotë dhe të detajuar aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2025. Raporti synon të ofrojë një panoramë të qartë të punës së kryer, rezultateve të arritura dhe sfidave të hasura, në funksion të realizimit të misionit dhe objektivave strategjike të institucionit.

Struktura e raportit është ndërtuar mbi bazën e një raportimi të detajuar për çdo drejtori përbërëse të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së, duke analizuar veprimtarinë e tyre në përputhje me objektivat e miratuara për vitin 2025. Në këtë kuadër, raporti vë theks të veçantë në:

- Administrimin efektiv të skemës së ndihmës ekonomike, me synim rritjen e transparencës dhe mbështetjes për shtresat në nevojë;
- Zhvillimin dhe forcimin e shërbimeve të përkujdesit social, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e komunitetit;
- Mirëadministrimin financiar dhe menaxhimin eficient të burimeve njerëzore, si elementë kyç për funksionimin e qëndrueshëm të institucionit;
- Konsolidimin e skemës së vlerësimit biopsikosocial dhe mirëadministrimin e skemave të vlerësimit, duke garantuar shërbime më cilësore për përfituesit;
- Menaxhimin e kujdesshëm dhe në kohë të kërkesave dhe ankesave të paraqitura përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale, si dhe drejtpërdrejt pranë zyrave të Shërbimit Social Shtetëror.

Në tërësi, raporti dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të institucionit për rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale, përmirësimin e proceseve administrative dhe forcimin e besimit të qytetarëve ndaj Shërbimit Social Shtetëror.

### **DREJTOR I PËRGJITHSHËM**


**Reme Xholi**

## **I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK**

### **NDIHMA EKONOMIKE**

#### ***1. Ecuria e skemës së ndihmës ekonomike për periudhën janar – dhjetor 2025***

Numri mesatar i familjeve/individëve përfitues për vitin 2025 është 50.600 familje, ku 67% e familjeve janë deri në 4 anëtarë dhe 34% me më shumë se 4 anëtarë, 5% e famijeve përfituese i përkasin komunitet rom & egjiptian, kryesisht në qarqet Elbasan, Tiranë, Korçë, Lezhë, Durrës dhe Dibër. Numri i individëve përfitues gjithsej në skemën e NE-së është mesatarisht 181.171 individë, nga të cilët 49% ose 89.186 femra dhe 51% ose 92.685 meshkuj.



Ndërkohë familje përfituese të cilët kanë individë me aftësi të kufizuar zënë 20% të familjeve në skemën e NE-së dhe janë gjithsej 10.509 individë me aftësi të kufizuar që trajtohen nga skema e mbrojtjes sociale. Nisur nga struktura e familjes përfitojnë dyfishin e masës së pagesës 11.138 familje ose 23% e totalit të familjeve përfituese.

#### ***1.1 Hyrjet e reja***

Referuar dinamikës për hyrjet e reja me përjashtim të muajit Janar që përkon me fillimin e vitit dhe ka gjithmonë numër më të lartë të aplikimeve, janë mesatarisht 818 familje që aplikojnë për herë të parë/riaplikime. Qarqet me numrin më të lartë të hyrjeve të reja janë qarqet Elbasan, Dibër, Kukës, Korçë dhe Shkodër.

#### ***1.2 Dinamika e refuzimeve Janar – Dhjetor 2025 nga sistemi i pikëzimit***

Referuar dinamikës së përfituesve nga skema e NE-së, vihet re një ulje e konsiderueshme e numrit të familjeve përfituese që kryesisht rezultojnë të jenë refuzuar nga Drejtoritë Rajonale gjatë verifikimit automatik me arsye të ndryshme, të tilla, si: mospërputhje e situatës social-ekonomike gjatë vizitës së kryer në banesë, mosdeklarimi i të ardhurave/aseteve që disponojnë ose mosparaqitja e anëtarëve madhorë gjatë deklarimit 3-mujor etj.

#### **Arsyet e Refuzimit**

Qarqet të cilat kanë një ulje të konsiderueshme të numrit të familjeve janë qarqet Dibër, Kukës, Korçë, dhe Elbasan duke qenë edhe qarqet që mbartin numrin më të lartë të familjeve përfituese, bazuar kjo edhe në gjetjet e task-forcës, pasi këto 4 qarqe kanë rezultuar me riskun më të lartë krahasuar me 8 qarqet e tjera. Nisur nga problematikat e gjetura është vijuar me planin e masave dhe rekomandimeve,

të cilat janë pasqyruar në vazhdimësi në planin e punës për vitin 2025 duke u bazuar në riskun që mbartin Bashkitë/Njësitë Administrative si dhe në shtimin e numrit të kontrolleve tematike.

### 1.3 Kategoritë/individët në nevojë

Ndryshe nga dinamika e familjeve në nevojë që vlerësohen nga sistemi i pikëzimit, kategoritë e tjera përfituese të përfshira në skemën e NE-së, afatet e përfitimit i kanë të përcaktuara në dokumentacionin përkatës (urdhër mbrojtje, status jetimi, vendim gjykate). Këtu bën përjashtim kategoria e prindërve me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh të cilët janë pjesë e familjeve në nevojë, por nuk i nënshtrohen vlerësimit përmes pikëzimit.

| Muaji        | Total Kategori | Status Jetimi | Viktima Dhune | Trinjak | Viktima Trafikimi | Katërnjak | Fëmijë në Kujdestari të një familje kujdestare | Fëmijë me aftësi të kufizuar në kujdestari |
|--------------|----------------|---------------|---------------|---------|-------------------|-----------|------------------------------------------------|--------------------------------------------|
| Janar 2025   | 2613           | 1130          | 1098          | 53      | 14                | 1         | 303                                            | 14                                         |
| Shkurt 2025  | 2571           | 1125          | 1060          | 53      | 14                | 1         | 305                                            | 13                                         |
| Mars 2025    | 2640           | 1156          | 1097          | 50      | 14                | 1         | 309                                            | 13                                         |
| Prill 2025   | 2663           | 1184          | 1087          | 50      | 14                | 1         | 313                                            | 14                                         |
| Maj 2025     | 2672           | 1194          | 1083          | 50      | 14                | 1         | 315                                            | 14                                         |
| Qershor 2025 | 2712           | 1215          | 1110          | 50      | 14                | 1         | 308                                            | 14                                         |
| Korrik 2025  | 2702           | 1208          | 1110          | 48      | 15                | 1         | 306                                            | 14                                         |
| Gusht 2025   | 2740           | 1220          | 1128          | 50      | 16                | 1         | 311                                            | 14                                         |
| Shtator 2025 | 2754           | 1254          | 1112          | 49      | 17                | 1         | 308                                            | 13                                         |
| Tetor 2025   | 2792           | 1242          | 1162          | 51      | 17                | 2         | 305                                            | 13                                         |
| Nëntor 2025  | 2785           | 1257          | 1143          | 52      | 17                | 2         | 301                                            | 13                                         |
| Dhjetor 2025 | 2846           | 1314          | 1149          | 53      | 17                | 2         | 299                                            | 12                                         |

Kategoritë më dinamike i përkasin përfituesve nga statusi i jetimit dhe viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare.

### 1.4 Kompensimi i energjisë elektrike dhe subvencioni për arsimin e detyruar

Përsa i përket subvencionimit të fëmijëve të grupmoshës 5-16 vjeç për arsimin e detyruar referuar muajit Tetor, kanë përfituar 30452 fëmijë ose rreth 91% e fëmijëve të kësaj grupmoshe. Qarqet Dibër, Korçë dhe Elbasan kanë një përqindje më të ulët duke e krahasuar me qarqet e tjera lidhur me ndjekjen e arsimit të detyruar.

Për vitin 2025 kanë përfituar subvencionimin e energjisë elektrike 15.366 familje ose 33 % e familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike. Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelë vihet re se, numri i familjeve përfituese të subvencionit të EE në raport me numrin e familjeve përfituese është i ulët për shkak të mungesës së dokumentacionit që kërkohet në legjislacion, si kontrata me OSHE për familjet që jetojnë me qira dhe për ato raste kur kontrata nuk është në emrin e kryefamiljartit dhe aty jetojnë më shumë se një kurorë në një banesë.

## 2. Kontrolle të planifikuara/kryera në 12 drejtoritë rajonale të SHSSH

### 2.1 Kontrollët, Sektori NE

Për periudhën Janar – Dhjetor 2025, Sektori i Kontrollit të Pagesës së NE-së bazuar në planin e Veprimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm ka kryer 9 kontrole, nga të cilat 7 kontrole të plota, përkatësisht

në Drejtoritë Rajonale Kukës, Lezhë, Vlorë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Dibër, si dhe 2 kontrolle tematike në njësitë vendore, konkretisht Bashkia Devoll dhe njësia administrative Maqellarë e Bashkisë Dibër.

Në zbatim të Metodologjisë së kontrollit të ndihmës ekonomike janë kryer kontrolle të detajuara mbi veprimtarinë e 9 drejtorive gjatë vitit 2025, me fokus të veçantë vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor, procedurave administrative dhe performancës së tyre. Këto kontrolle janë realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet përkatëse të kontrollit, duke u përqëndruar në identifikimin e mangësive dhe rreziqeve që ndikojnë në performancën e Drejtorive Rajonale. Në vijim të këtij procesi dhe në përputhje me kërkesat ligjore, është realizuar një analizë krahasuese mbi zhvillimet, progresin e arritur dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme.

Për sa më sipër, krahasuar me periudhën e mëparshme vihet re se është punuar dhe ka përmirësim mbi cilësinë e kontrolleve, por mbetet problematik në disa prej drejtorive rajonale procedura jo e saktë gjatë verifikimit automatik si më poshtë:

**Tabela e kontrolleve Janar-Dhjetor 2025**

| Drejtoria Rajonale/Njësi Vendore | Kontroll i Plotë/Tematik      | Nr. verifikimeve social-ekonomike | Nr. familjeve të larguara nga verifikimi social-ekonomik | Mashttrim |               | Gabim    |               | Dëmi Ekonomik |               | Masa Administrative          |
|----------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------------------------------|-----------|---------------|----------|---------------|---------------|---------------|------------------------------|
|                                  |                               |                                   |                                                          | Nr. fam   | Fond          | Nr. fam  | Fond          | Nr. fam       | Fond          |                              |
| DR Rajonale Kukës                | I Plotë                       | /                                 | /                                                        | 0         | 0             | 0        | 0             | 0             | 0             | Gjobë                        |
| DR Rajonale Lezhë                | I Plotë                       | /                                 | /                                                        | 0         | 0             | 0        | 0             | 0             | 0             | Masë disiplinore             |
| DR Rajonale Vlorë                | I Plotë                       | /                                 | /                                                        | 0         | 0             | 0        | 0             | 0             | 0             |                              |
| DR Rajonale Fier                 | I Plotë                       | /                                 | /                                                        | 0         | 0             | 0        | 0             | 0             | 0             |                              |
| DR Rajonale Shkodër              | I Plotë                       | /                                 | /                                                        | 0         | 0             | 0        | 0             | 0             | 0             |                              |
| DR Rajonale Korçë                | I Plotë                       | /                                 | /                                                        | 3         | 458130        | 0        | 0             | 3             | 458130        | Shpërblim dëmi               |
| Bashkia Devoll                   | Tematik                       | 43                                | 4                                                        | 4         | 0             | 0        | 0             | 4             | 0             |                              |
| DR Rajonale Dibër                | I Plotë                       | /                                 | /                                                        | 0         | 0             | 1        | 166320        | 1             | 166320        | Shpërblim dëmi               |
| Maqellarë, Bashkia Dibër         | Tematik                       | 53                                | 15                                                       | 15        | 0             | 0        | 0             | 15            | 0             | 2 Gjoba                      |
| <b>TOTALI</b>                    | <b>2 Tematike/ 7 të plota</b> | <b>96</b>                         | <b>19</b>                                                | <b>22</b> | <b>458130</b> | <b>1</b> | <b>166320</b> | <b>23</b>     | <b>624450</b> | <b>6 masa administrative</b> |

### **Realizimi dhe problematikat e konstatuara gjatë kontrolleve të kryera nga DKP mbi NE**

**Kontroll i plotë në Drejtorinë Rajonale Kukës**, për periudhën Janar 2022-Janar 2025, ku u konstatuan problematikat kryesore si më poshtë:

- Janë evidentuar familje me pagesa të parregullta dhe nuk është ndjekur procedura e arkëtimit;
- Lidhur me kontrollin e zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike, nuk është punuar specifikisht duke trajtuar dhe detajuar çdo çështje në raportin e kontrollit;

- Familjet që trajtohen nga fondi deri në 6% rezultojnë në numër të konsiderueshëm pa vizita të kryera ose të kryera me vonesë si dhe kanë afat përfitimi mbi 3 vjet pa shkëputje dhe pa pasur një aplikim të ri;
- Formularët e aplikimit për ndihmën ekonomike nuk janë të përditësuar si dhe hedhja e vizitave në familje nuk është kryer;
- DRSHSSH nuk ka monitoruar dhe kontrolluar raportin e riaplikimeve para afatit 6 mujor dhe 1 vjeçar të penalizimit;
- Nga verifikimi i kryer në sistem u identifikuan familje të cilat rezultonin me anëtarë të punësuar, por që në formularin e aplikimit nuk kishin deklaruar pagën;
- Për kategorinë “Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë”, rezultuan familje për të cilat administratorët shoqërorë nuk kanë kryer verifikimin social-ekonomik në banesë dhe që kanë marrë dy herë përfitime nga skema e NE;
- Lidhur me kategorinë “Jetimë që nuk janë në institucione” nga verifikimi rezultoi se mospërputhjet e ardhura për pagat nga DPT-ja, nuk janë trajtuar nga ana e verifikuesve;
- Verifikuesit e Drejtorisë Rajonale Kukës nuk e kanë kryer plotësisht dhe me saktësi procedurën e verifikimeve automatike.

**Kontroll i plotë në Drejtorinë Rajonale Lezhë**, për periudhën Janar 2022-Janar 2025, ku u konstatuan problematikat kryesore si më poshtë:

- Lidhur me cilësinë dhe trajtimin e çështjeve në kontrollet e kryera të përzgjedhura është punuar pjesërisht mbi zbatimin e VKM-së Nr. 257, datë 05.05.2021;
- Janë evidentuar familje me pagesa të parregullta me lekë për të cilat është ndjekur procedura e arkëtimit;
- Familjet që trajtohen nga fondi deri në 6% rezultojnë në numër të konsiderueshëm pa vizita të kryera ose të kryera me vonesë si dhe kanë afat përfitimi mbi 3 vjet pa shkëputje dhe pa pasur një aplikim të ri;
- Mungojnë komentet për verifikimet automatike në rastet kur nuk konsiderohet shkelje mospërputhja e ardhur, me arsyen pse nuk konsiderohet shkelje;
- Janë konstatuar raste të cilat, gjatë procesit të trajtimit të mospërputhjeve nga ana e verifikuesve janë konstatuar shkelje me arsye të ndryshme dhe nuk janë refuzuar nga ana e vendimmarrësit pasi rezultojnë të punësuar për një periudhë 1 (një) mujore ose rezultojnë me rritje të masës së pagës përsëri për muajin e fundit të verifikimit dhe nuk është plotësuar afati 3 mujor gjatë të cilit familjet kanë detyrimin ligjor për të deklaruar të gjitha ndryshimet e gjendjes social-ekonomike;
- Për kategorinë “Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, rezultoi se nuk është ndjekur procedura e trajtimit të mospërputhjeve të ardhura me institucionet me të cilat realizohet kryqëzimi i informacionit;
- Për kategorinë “Jetimët që nuk janë në institucion” nga verifikimi rezultoi se mospërputhjet e ardhura për pagat nga DPT nuk janë trajtuar nga ana e verifikuesve;
- Rezultojnë familje përfituese për të cilat administratori shoqëror nuk ka kryer vizitat në familje në muajin e aplikimit për ata që aplikojnë për herë të parë;
- Procedura e ndjekur nga ana e administratorit shoqëror për vizitat e kryera në banesë nuk është e saktë;
- DRSHSSH nuk ka monitoruar dhe kontrolluar raportin e riaplikimeve para afatit 6 mujor dhe 1 vjeçar të penalizimit.

**Kontroll i plotë në Drejtorinë Rajonale Vlorë**, për periudhën Qershor 2022-Prill 2025, ku u konstatuan problematikat kryesore si më poshtë:

- Lidhur me familjet që trajtohen nga fondi deri në 6% rezulton se, është ndjekur me saktësi procedura e përfitimeve në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi përveç 2 familjeve të cilat rezultojnë ende pa vizita të kryera dhe për 3 familje verifikimi social-ekonomik është kryer me vonesë.

**Kontroll i plotë në Drejtorinë Rajonale Fier**, për periudhën Korrik 2023-Maj 2025, ku u konstatuan problematikat kryesore si më poshtë:

- DRSHSSH ka vijuar me zbatimin e VKM nr.855, dt. 26.12.2024, mbi vizitat fillestare, por nuk i ka pasqyruar ato në sistemin elektronik;
- Lidhur me familjet që trajtohen nga fondi deri në 6% rezulton se, nuk është ndjekur me saktësi procedura e përfitimeve në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

**Kontroll i plotë në Drejtorinë Rajonale Shkodër**, për periudhën Prill 2023-Qershor 2025 ku u konstatuan problematikat kryesore si më poshtë:

- Kontrolllet kanë qenë të plota dhe tematike në varësi të riskut në të gjitha njësitet ku dhe plani i punës është realizuar plotësisht;
- Lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në raportin e kontrollit të mëparshëm janë realizuar pjesërisht;
- Konstatohet një numër i ulët i familjeve të cilat rezultojnë me anëtarë madhorë që deklarojnë se janë punësuar nga Zyrat e Punës në Programet e Nxitjes së Punësimit apo Punës në Komunitet;
- Konstatohet se jo në të gjithë formularët e aplikimit masa e përfitimit të pensionit është e pasqyruar me saktësi dhe janë konstatuar diferenca të vogla të cilat përgjithsisht konsistojnë nga indeksimi çdo vit i pensioneve;
- Vihet re se, nga ana e administratorëve shoqërorë nuk janë pasqyruar me saktësi ndryshimet e gjendura gjatë vizitës në banesë dhe se nuk janë kryer rregullisht vizita në familje në muajin e aplikimit për ata që aplikojnë për herë të parë, apo dy herë në vit për ata që janë përfitues të NE;
- DRSHSSH Shkodër ka kryer një numër shumë të ulët të vizitave në banesë për familjet që aplikojnë për herë të parë;
- Lidhur me familjet që trajtohen nga fondi deri në 6% rezulton se, nuk është ndjekur me saktësi procedura e përfitimeve në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

**Kontroll i plotë në Drejtorinë Rajonale Korçë**, për periudhën Korrik 2022-Korrik 2025, janë konstatuar problematika si më poshtë:

- Plani i punës për çdo vit nuk është realizuar plotësisht;
- Kontrolllet nuk janë kryer në muajin e parashikuar sipas planit të punës, por në vazhdimësi si dhe hartimi i projekt raportit dhe raportit përfundimtar rezultojnë në tejkalim të afateve të përcaktuara në metodologjinë e kontrollit;
- Lidhur me pagesat e përfituara në kundërshtim me legjislacionin e NE-së, për periudhën objekt kontrolli Korrik 2022-Dhjetor 2025 nuk ka informacion zyrtar mbi ndalesat e kryera (këtu sqarojmë se, për ato familje të cilat nuk janë më pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, mbajtja e pagesës është pothuajse e pamundur);



- Lidhur me masat administrative është evidentuar se kur shkeljet kanë qënë të përsëritura, masat e vendosura jo në të gjitha rastet kanë qënë në përputhje me gjetjet dhe shkeljet e konstatuara sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 257, datë 05.05.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale”, Shtojca nr.1 “Metodologjia e Kontrollit Të Ndihmës Ekonomike”;
- Mbi zbatimin e detyrave të lëna në raportin e kontrollit të mëparshëm është konstatuar se vijojnë ende detyra të parealizuara;
- DRSHTSH Korçë ka kryer një numër shumë të ulët të vizitave në banesë për familjet që aplikojnë për herë të parë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- Gjatë kontrollit në sistem janë konstatuar familje të cilat rezultojnë me anëtarë të vetëpunësuar dhe me aktivitet/veprimtari me status aktiv, por nuk deklarojnë të ardhurat apo nuk ndodhen në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike;
- Lidhur me kategorinë “Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë”, rezultoi se nuk është ndjekur procedura e trajtimit të mospërputhjeve të ardhura nga institucionet me të cilat realizohet kryqëzimi i informacionit;
- Vihet re se, nga ana e administratorëve shoqërorë nuk janë pasqyruar me saktësi ndryshimet e gjendura gjatë vizitës në banesë dhe se nuk janë kryer rregullisht vizita në familje në muajin e aplikimit për ata që aplikojnë për herë të parë, apo dy herë në vit për ata që janë përfitues të NE.

**Kontroll Tematik i kryer në Bashkinë Devoll, Njësitë Administrative Proger, Miras dhe Hoçisht** për periudhën Tetor 2024-Gusht 2025, janë konstatuar problematika si më poshtë:

- Për familjet me anëtarë në moshë aktive pune, gjatë verifikimit u konstatuan familje të cilat deklaruan se një prej anëtarëve, KF ose bashkëshortja, punojnë me ditë në Shtetin fqinj Greqi duke qënë se është zonë kufitare, por jo të gjithë i deklarojnë të ardhurat;
- Nga 43 verifikime social-ekonomike të kryera rezultoi se për 30 familje situata social-ekonomike paraqitej në gjendje mesatare, për 9 familje që nuk u gjendën në banesë u la detyrë dhe verifikimi është kryer sërish nga punonjësit e njësisë, ku janë larguar nga skema 2 familje pasi nuk ndodheshin në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, ndërsa për 4 familje u la detyrë largimi nga skema pasi vlerësimi i kryer nga administratori shoqëror si familje në nevojë nuk përputhet me gjendjen reale të familjeve;
- Lidhur me përshkrimet në rubrikën e komenteve në sistemin elektronik të NE-së, nga ana e administratorëve shoqërorë (kryesisht në njësinë administrative Miras) u konstatua se nuk janë të detajuara, pa përshkruar saktë situatën social-ekonomike të familjeve.

**Kontroll i plotë në Drejtorinë Rajonale Dibër**, për periudhën Shtator 2023-Tetor 2025, janë konstatuar problematika si më poshtë:

- Kontrollat kanë qënë të plota dhe tematike në varësi të riskut në të gjitha njësitë ku dhe plani i punës është realizuar plotësisht;
- Lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në raportin e kontrollit të mëparshëm janë realizuar përveç detyrave që lidhen me arkëtimin e pagesave nga familjet që kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin (këtu sqarojmë se, për ato familje të cilat nuk janë më pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, mbajtja e pagesës është pothuajse e pamundur);
- Lidhur me hartimin e projekt raportit dhe raportit përfundimtar rezulton se jo në të gjitha rastet janë respektuar afatet e përcaktuara në metodologjinë e kontrollit;
- Lidhur me procedurën e ndjekur nga administratori shoqëror për plotësimin e formularëve të aplikimit nga verifikimi janë konstatuar raste ku, të dhënat e pasqyruara në formular sikurse është deklarimi i pagave dhe pyetja “A ka punuar 4 javët e fundit?” nuk janë plotësuar saktë;

- Gjatë kontrollit të verifikimeve automatike të pagave, janë konstatuar aplikime të cilat nuk janë kryer në emër të kryefamiljarit, por në emër të anëtarëve të tjerë të familjes, në kundërshtim kjo me përcaktimin e pikës 1, Kreu II të VKM-së Nr.597/2019;
- Lidhur me kategorinë “Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë”, rezultoi se është ndjekur procedura e trajtimit të mospërputhjeve të ardhura nga institucionet me të cilat realizohet kryqëzimi i informacionit, por u konstatua se për 4 familje administratorët shoqëror nuk kanë kryer verifikimin social-ekonomik në banesë në kundërshtim me përcaktimin e VKM-së Nr.597, Kreu I, pika 4.3;
- Për kategorinë “Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë” rezultoi se një familje është njëkohësisht përfituese si kategori “Prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh” dhe si familje në nevojë, duke marrë dy herë përfitime nga skema e ndihmës ekonomike;
- Për familjet që trajtohen nga fondi deri në 6% rezultojnë në numër të konsiderueshëm pa vizita të kryera ose të kryera me vonesë si dhe kanë afat përfitimi mbi 1-2 vjet pa shkëputje dhe pa pasur një aplikim të ri;
- Gjatë verifikimit automatik janë konstatuar 3 familje të cilat gjatë kohës së qëndrimit në skemë kanë blerë/shitur disa mjete motorrike për të cilat Drejtorisë Rajonale nuk i vijnë mospërputhjet pasi mjeti është i deklaruar në formularin e aplikimit dhe si rrjedhojë nuk mund t’i konstatojë si shkelje;
- Administratorët shoqërorë nuk kanë kryer rregullisht vizitat në familje në muajin e aplikimit për ata që aplikojnë për herë të parë, apo dy herë në vit për ata që janë përfitues. Gjithashtu vihet re se përgjithësisht vizitat hidhen pa komente në rubrikën e vizitave ose pa komente të detajuara, si pasojë u konstatua numër i ulët i vizitave të hedhura me ndryshime në sistem.

**Kontroll Tematik i kryer në Bashkinë Dibër, Njësia Administrative Maqellarë**, për periudhën Tetor 2024-Nëntor 2025, janë konstatuar problematika si më poshtë:

- Administratori shoqëror në njësinë Maqellarë i cili aktualisht mban detyrën si punonjës i PAK dhe prej muajit Prill 2025 është ngarkuar të kryejë edhe detyrat e punonjësit të NE-së, njëhte mirë zonat/fshatrat, kishte informacion të saktë dhe specifik lidhur me problematikat social ekonomike për familjet ekzistuese që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike;
- Si zonë përgjithësisht fushore dhe me toka bujqësorë konstatuam se, jo në të gjitha rastet familjet kanë të deklaruar në formularin e aplikimit të ardhura pasi sipas informacionit të dhënë nga vetë familjarët tokat nuk shfrytëzohen për prodhime ose për të krijuar të ardhura;
- Për familjet me anëtarë në moshë aktive pune, gjatë verifikimit u konstatuan mosprezencë në disa prej familjeve anëtarë madhorë për të cilët familjarët deklaruan se punojnë me ditë në Shtetin fqinj Maqedoni/Dibër e Madhe duke qënë se janë zona kufitare, por jo të gjithë deklarojnë të ardhurat që mund të krijohen;
- Nga 53 verifikime social-ekonomike të kryera rezultoi se për 28 familje situata social-ekonomike paraqitej në gjendje mesatare, për 10 familje që nuk u gjenden në banesë u la detyrë dhe verifikimi është kryer sërish nga punonjësit e njësisë, ku janë larguar nga skema 4 familje pasi nuk ndodheshin në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, ndërsa për 15 familje u la detyrë largimi nga skema pasi vlerësimi i kryer nga administratori shoqëror si familje në nevojë, nuk përputhej me gjendjen reale të familjeve;
- Lidhur me rubrikën “vizita në banesë”, administratori shoqëror nuk ka përshkruar saktë situatën social-ekonomike ose nuk ka vendosur një përshkrim të mëparshëm mbi kushtet e familjeve;

- Si rezultat i kontrollit në këtë njësi evidentuam se punonjësit në detyrë për periudhën objekt kontrolli, nuk kanë punuar në përputhshmëri me të gjitha kërkesat për zbatimin e legjislacionit të NE-së pasi kanë lejuar të jenë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike familje të cilat nuk konsiderohen familje në nevojë. Për pasojë janë propozuar masa administrative.

## 2.2 Analiza e kontrolleve të zbatimit të legjislacionit në njësitë vendore në nivel kombëtar

Për periudhën Janar – Dhjetor 2025, Drejtoritë Rajonale në 12 qarqe në zbatim të planit të Veprimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm kanë kryer në total 219 kontrolle për NE në njësi administrative.

Gjithsej 219 kontrolle, ndër të cilat 45 kontrolle kanë qenë tematike dhe 174 kontrolle të plotë. Janë konstatuar 375 familje që kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin me dëm ekonomik 825.2481 lekë dhe janë propozuar 72 masa administrative.

**Tabela e Kontrolleve Janar-Dhjetor 2025 NE**


| QARKU         | Numri i kontrolleve NE | Kontroll i Plotë/Tematik         | Nr. verifikimeve social-ekonomike | Nr. familjeve të larguara nga verifikimi social-ekonomik | Mashttrim |                | Gabim      |                | Dëmi Ekonomik |                | Masa Administrative                                     |
|---------------|------------------------|----------------------------------|-----------------------------------|----------------------------------------------------------|-----------|----------------|------------|----------------|---------------|----------------|---------------------------------------------------------|
|               |                        |                                  |                                   |                                                          | Nr. fam   | Fond           | Nr. fam    | Fond           | Nr. fam       | Fond           |                                                         |
| TIRANË        | 18                     | 3 tematike/15 të plotë           | 186                               | 0                                                        | 0         | 0              | 0          | 0              | 0             | 0              | 1 masë disiplinore                                      |
| DURRËS        | 11                     | 11 të plota                      | 357                               | 8                                                        | 0         | 0              | 23         | 257037         | 23            | 257037         | 3 masa "shpërblim dëmi"                                 |
| FIER          | 12                     | 4 tematike/ 8 të plota           | 83                                | 2                                                        | 0         | 0              | 2          | 0              | 2             | 0              |                                                         |
| VLOREË        | 20                     | 3 tematike/ 17 të plota          | 327                               | 1                                                        | 0         | 0              | 4          | 20454          | 4             | 20454          | 2 masa "shpërblim dëmi"                                 |
| BERAT         | 22                     | 3 tematike/ 19 të plota          | 278                               | 13                                                       | 0         | 0              | 19         | 172589         | 19            | 172589         | 1 masë disiplinore                                      |
| GJIROKASTËR   | 11                     | 11 të plota                      | 53                                | 0                                                        | 2         | 96704          | 0          | 0              | 2             | 96704          | 1 masë disiplinore + 1 masë "shpërblim dëmi"            |
| SHKODËR       | 19                     | 2 tematike/ 17 të plota          | 60                                | 3                                                        | 0         | 0              | 190        | 4677721        | 190           | 4677721        | 15 masa "shpërblim dëmi" + 8 masa disiplinore + 5 gjoba |
| KORÇË         | 19                     | 4 tematike/ 15 të plota          | 473                               | 3                                                        | 1         | 25160          | 0          | 0              | 1             | 25160          | 1 masë disiplinore                                      |
| KUKËS         | 25                     | 8 tematike/ 17 të plota          | 511                               | 1                                                        | 0         | 0              | 42         | 1079383        | 42            | 1079383        | 1 masë disiplinore                                      |
| DIBËR         | 26                     | 9 tematike/ 17 të plota          | 320                               | 48                                                       | 0         | 0              | 42         | 30228          | 42            | 30228          | 2 masa disiplinore + 3 masa "shpërblim dëmi"            |
| ELBASAN       | 19                     | 5 tematike/ 14 të plota          | 240                               | 22                                                       | 43        | 1818064        | 7          | 75141          | 50            | 1893205        | 15 masa "shpërblim dëmi" + 9 masa disiplinore + 4 gjoba |
| LEZHË         | 17                     | 4 tematike/ 13 të plota          | 489                               | 8                                                        | 0         | 0              | 0          | 0              | 0             | 0              |                                                         |
| <b>TOTALI</b> | <b>219</b>             | <b>45 tematike/ 174 të plota</b> | <b>3377</b>                       | <b>109</b>                                               | <b>46</b> | <b>1939928</b> | <b>329</b> | <b>6312553</b> | <b>375</b>    | <b>8252481</b> | <b>72 masa administrative</b>                           |

Qarku me numrin më të lartë të kontrolleve të realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2025 është qarku i Kukësit me 50 kontrolle të kryera (25 kontrolle NE + 25 kontrolle PAK). Në raport me numrin total të njësive vendore të qarkut, qarku i Kukësit ka realizuar kontrolle NE në 93% të njësive të qarkut për vitin 2025 (e njëjta përqindje dhe për kontrollet PAK). Ndërmjet kontrolleve të kryera, 32% e tyre janë kontrolle tematike. Plani i punës është i realizuar në masën 100%. Vlen për t'u theksuar që qarku i Kukësit është cilësuar si qarku më i varfër gjatë verifikimeve të Task-Forcës në vitin 2024.

Qarku i Fierit është qarku me numrin më të ulët të kontrolleve në raport me numrin total të njësive, ku rezultojnë 28% të njësive të kontrolluara për vitin 2025, kjo për shkak se qarku në total ka një numër të ulët përfituesish krahasuar me qarqet e mëdhaja të vendit. Gjithashtu ky qark ka një numër të lartë njësish të cilat kanë një numër të ulët familje përfituese, pra konsiderohen njësi të vlerësuara me risk shumë të ulët. Ndërmjet kontrolleve të kryera, 33% e tyre janë kontrolle tematike, plani i punës është i realizuar në masën 90% për vitin 2025.

Referuar kontrolleve të kryera, qarku Shkodër është qarku me numrin më të lartë, rreth 190 familje të konstatuara gabim dhe për rrjedhojë dëmi ekonomik dhe masat administrative janë propozuar në përputhje me dëmin e shkaktuar. Rastet më të shpeshta janë riaplikime për të cilat arkëtohen lekët si dhe moscekimi i pyetjes së invaliditetit.

Referuar VKM-së nr. 855, datë 26.12.2024, Drejtoritë Rajonale duhet të kenë një fokus të veçantë në kryerjen e verifikimeve social-ekonomike, sidomos për familjet të cilat aplikojnë për herë të parë në Skemën e Ndihmës Ekonomike. Në kontrollet e kryera në njësitë vendore, qarku Shkodër ka numrin më të ulët të verifikimeve social-ekonomike.



Në raport me numrin total të kontrolleve të NE-së të kryera gjatë vitit 2025, numrin më të lartë të verifikimeve social-ekonomike për çdo kontroll të kryer e mban qarku i Durrësit, i cili ka kryer mesatarisht 32 verifikime për kontroll.

Nga ana tjetër, qarku Lezhë dhe Tiranë nuk kanë konstatuar asnjë familje që ka përfituar pagesë në kundërshtim me legjislacionin në kontrollet e kryera gjatë këtij viti. Ndërsa qarku Korçë ka konstatuar vetëm 1 familje e cila ka përfituar pagesë në kundërshtim me legjislacionin përgjatë gjithë kontrolleve të kryera të vitit 2025. Duke qenë qark me një numër të lartë përfituesish, por edhe me një numër të lartë të familjeve të konstatuara në kushte social-ekonomike “shumë të mira” gjatë verifikimeve të Task-Forcës në vitin 2024, bie ndesh me gjetjet e sipërcituara.

### **2.3 Problematikat e konstatuara nga kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale në Bashki/Njësi vendore**

- Mosfirmosje të deklaratave 3-mujore nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes;

- Mungojnë ose kryhen me vonesë verifikimet e situatës social-ekonomike për hyrjet e reja dhe familjet ekzistuese të NE-së;
- Nuk plotësohet saktë formulari i vizitës në familje nga administratorët shoqërorë sipas të gjitha rubrikave përkatëse (përshkrimi tek rubrika e komenteve mbi situatën social-ekonomike të familjeve mungon);
- Nuk janë përditësuar formularët e aplikimit për familjet përfituese të ndihmës ekonomike lidhur me rritjen e pagës minimale dhe indeksimin e pensioneve;
- Moschekimi i pyetjes në formularin e aplikimit për ato familje të cilët kanë anëtarë PAK;
- Nuk respektohet afati ligjor i penalizimit 6-mujor dhe 1-vjeçar nga ana e administratorit shoqëror për familjet e refuzuara nga skema e ndihmës ekonomike;
- Për familjet përfituese nga fondi deri në 6% nuk zbatohet kriteri i vizitës paraprake;
- Në disa qarqe të vendit problematikë e theksuar mbetet bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë/Njësisë Administrative dhe Drejtorisë Rajonale (Qarku Korçë/ Bashkia Devoll, Qarku Shkodër/Bashkia Vau Dejës).
- Dhënia e kompensimit të EE në kundërshtim me legjislacionin (mungesë dokumentacioni).

### ***3. Integrimi, orientimi dhe punësimi i anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së drejt tregut të punës***

Me qëllim transformimin e programit të NE në një skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim, në kuadër të zbatimit të VKM-së nr. 882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstytucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune, të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”, VKM-së nr. 855, datë 26.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të NE dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar janë referuar te zyrat e punës për periudhën Janar- Dhjetor rreth 1569 anëtarë në moshë aktive pune, nga të cilët janë punësuar 409 individë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike dhe adresuar për formim profesional 214 anëtarë në moshë aktive pune. Gjatë kësaj periudhe, për personat me aftësi të kufizuar janë referuar tek zyrat e punës 177 individë si kategori PAK në moshë aktive pune, nga të cilët janë punësuar 51 individë dhe adresuar për formim profesional 13 individë.

### ***4. VKM, Udhëzime dhe ndryshime ligjore gjatë vitit 2025***

Vendim nr. 855, datë 26.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 597, datë 4.9.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, është akti nënligjor i cili përcakton procedurën e aplikimit dhe përfitimit të NE. Ndryshimet e VKM-së konsistojnë:

- Në kuadër të transformimit të programit të NE në një skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim të anëtarëve të familjeve përfituese dhe me qëllim fuqizimin e familjeve përfituese të NE dhe riintegrimin e tyre në shoqëri, fokusi i ndryshimeve të përcaktuara në vendim ka qenë referimi i anëtarëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në programet e nxitjes së punësimit, riintegrimin social dhe punëve publike në komunitet. Për anëtarët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, të përfshirë në këto programe punësimi, nuk llogaritet masë përfitimi e ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes;

- Gjithashtu, një përcaktim tjetër i lidhur ngushtësisht me gjetjet e Task Forcës, është detyrimi për dorëzimin dy herë në vit të vërtetimit për hyrje-daljet nga territori shqiptar, të lëshuar nga portali “e-Albania” për të gjithë anëtarët madhorë të familjeve në nevojë;
- Një risi mjaft e rëndësishme e këtij vendimi e lidhur me kryerjen e vizitave në banesë, i referohet detyrimit që ka Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, që për familjet që aplikojnë për herë të parë, të kryejnë verifikimin në terren pas vlerësimit social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror si dhe hedhjen e tyre në sistem. Akses në sistem për hedhjen e verifikimit social-ekonomik në banesë kanë Drejtoritë Rajonale dhe DKP NE dhe PAK.
- Vendim nr. 835, datë 30.12.2025 “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta, për vitin 2025, pika 1, përfitojnë mbështetje financiare për vitin 2025, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë: a) familjet dhe individët, që trajtohen me ndihmë ekonomike sipas nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfshirë edhe ata që përfitojnë nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për NE; b) Fëmijët pa kujdes prindëror, të vendosur në familje kujdestare; c) Personat me aftësi të kufizuara, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

## **AFTËSIA E KUFIZUAR**

Referuar planeve vjetore të kontrollit, DRSHTSH kanë kontrolluar për pagesat e aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës 179 njësi vendore.

Gjatë kontrolleve janë konstatuar 575 dosje PAK që kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin me dëm ekonomik 15.401.496 dhe janë propozuar 89 masa administrative (9 masa disiplinore dhe 80 masa shpërblim dëmi). Në skemën e AK ndryshe nga skema e NE shpërblimi i dëmit arkëtohet pasi PAK janë përfitues, por janë paguar jo në përputhje me vendimin e KMCAP-it.

| QARKU         | Numri i Kontrolleve PAK | Kontroll i Plotë/Tematik | Numri i Dosjeve me Probleme (PAK) | Dëmi Ekonomik (PAK) | Numri i Dosjeve me Probleme (Invalidë Punë) | Dëmi Ekonomik (Invalidë Punë) | Dëmi ekonomik TOTAL PAK | Masa Administrative                          |
|---------------|-------------------------|--------------------------|-----------------------------------|---------------------|---------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------|----------------------------------------------|
| TIRANË        | 16                      | 16 të plota              | 1                                 | 3826                | 0                                           | 0                             | 3826                    | 1 masë "shpërblim dëmi"                      |
| DURRËS        | 12                      | 1 tematik/ 11 të plota   | 48                                | 1917781             | 1                                           | 6600                          | 1924381                 | 8 masa "shpërblim dëmi"                      |
| FIER          | 11                      | 1 tematik/ 10 të plota   | 36                                | 72000               | 0                                           | 0                             | 72000                   |                                              |
| VLORE         | 20                      | 3 tematike/ 17 të plota  | 29                                | 1228829             | 0                                           | 0                             | 1228829                 | 6 masa "shpërblim dëmi" + 2 masa disiplinore |
| BERAT         | 6                       | 6 të plota               | 0                                 | 0                   | 2                                           | 6600                          | 6600                    |                                              |
| GJIROKASTËR   | 11                      | 11 të plota              | 42                                | 1275390             | 0                                           | 0                             | 1275390                 | 7 masa "shpërblim dëmi"                      |
| SHKODËR       | 16                      | 16 të plota              | 186                               | 6177797             | 8                                           | 60500                         | 6238297                 | 13 masa "shpërblim dëmi" + 7 masa            |
| KORÇË         | 13                      | 13 të plota              | 0                                 | 0                   | 0                                           | 0                             | 0                       |                                              |
| KUKËS         | 25                      | 7 tematike/ 18 të plota  | 130                               | 2770502             | 0                                           | 0                             | 2770502                 | 17 masa "shpërblim dëmi"                     |
| DIBËR         | 19                      | 4 tematike/ 15 të plota  | 51                                | 447002              | 0                                           | 0                             | 447002                  | 9 masa "shpërblim dëmi"                      |
| ELBASAN       | 19                      | 3 tematike/ 16 të plota  | 52                                | 1508369             | 2                                           | 9900                          | 1518269                 | 15 masa "shpërblim dëmi"                     |
| LEZHË         | 11                      | 11 të plota              | 0                                 | 0                   | 0                                           | 0                             | 0                       |                                              |
| <b>TOTALI</b> | <b>179</b>              | <b>19 tematike</b>       | <b>575</b>                        | <b>15401496</b>     | <b>13</b>                                   | <b>83600</b>                  | <b>15485096</b>         | <b>89 masa administrative</b>                |

Qarqet me numrin më të lartë të dosjeve të evidentuar me shkelje janë qarqet Shkodër dhe Kukës. Dëmi ekonomik në qarkun e Shkodrës zë 40% të dëmit në total.

### ***Problematikat e evidentuara***

- Mos respektim i afateve të vendimeve në kryerjen e pagesave të KMCAP-it të nivelit të parë dhe Epror dhe KSHVAK, nga ana e administratorëve duke sjellë efekt ose dëm financiar;
- Mos hartimi i planit individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e KSHVAK-ve të PAK bazuar në gërmën a) të VKM Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për Përcaktimin e Masës, të Kriteve, Procedurave dhe Dokumentave për Vlerësimin dhe Përfitimin e AK të Ndihmës Personal, dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre”.
- Mos kryerja e vizitave në mjedisin ku jeton individ, jo më pak se një herë në tre muaj për personat përfitues të paaftësisë bazuar VKM-në Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për Përcaktimin e Masës, të Kriteve, Procedurave dhe Dokumentave për Vlerësimin dhe Përfitimin e AK të Ndihmës Personal, dhe të Strukturave Përgjegjëse e të Detyrave të Tyre”, i ndryshuar.

### ***Kontrolle të kryera/Spektori PAK***

Fokusi i kontrollit është zbatimi i legjislacionit të PAK pranë KSHVAK-ve në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, plotësimi i detyrimeve nga DRSHTSH dhe OSHKSH në përputhje me legjislacionin e AK në fuqi. Raportet janë bazuar në hapat e përcaktuara në përputhje me Metodologjinë e Kontrollit të Vlerësimit Biopsikosocial të AK.

Gjatë vitit 2025 sipas planit të punës, Urdhrit nr. 63 datë 08.02.2023 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit Biopsikosocial të përfituesve të AK” dhe Urdhrit nr. 141 datë 19.03.2025 “Kontrollin e skemës së vlerësimit Biopsikosocial të përfituesve të AK” janë kontrolluar dhe në proces kontrolli gjithsej 17 KSHVAK pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër, Lezhë, Berat, Korçë, Vlorë dhe Fier (Proces).

### ***Përmbledhje e kontrolleve***

Nga kontrolli i ushtruar në këto 17 KSHVAK janë konstatuar problematika si dhe janë lënë rekomandime dhe detyra si më poshtë:

- Nga kontrolli me përzgjedhje nga sistemi i 2.440 dosjeve fizike të PAK pranë KSHVAK-ve në Drejtoritë Rajonale Shkodër, Lezhë, Berat, Korçë, Vlorë dhe Fier (proces) u konstatua se në zbatim të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, pika 2 dhe 3 në çdo dosje ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, formulari i mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit si dhe dokumentacioni mjekësor i kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Biopsikosocial;
- Në 144 dosje mungon një pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Biopsikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225, datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores “Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funkcionimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, ku Mjeku i KSHVAK ka për detyrë të sigurojë që i tërë informacioni mjekësor plotëson standardet për vlerësimin dhe përcaktimin e AK dhe nivelin e dëmtimit në përputhje me kriteret e udhëzuesëve Biopsikosocialë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

*Grupi i kontrollit ka lënë detyrë që të vijohet me zbatimin e detyrave mbi plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e AK, si dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Biopsikosocial për të rritur dhe fëmijë.*

- Për 3 aplikantë, nuk duhej realizuar procedura e komisionimit, pasi diagnozat nuk përfshihen në Udhëzuesin e Vlerësimit Biopsikosocial;
- DRSHSSH duhej të refuzonte me shkresë zyrtare aplikimet jashtë kriterëve;
- Mjekët e familjes dhe mjekët specialistë kanë plotësuar formularët në kundërshtim me Udhëzuesit e Vlerësimit Biopsikosocial;
- Për 8 raste afati i përfitimit është përcaktuar me efekt prapaveprues. Dëmi ekonomik i shkaktuar në total është 444.040 Lekë;

Është lënë detyrë shpërblimi e dëmit nga zyrarët që e kanë shkaktuar, përkatësisht për rastet jashtë kriterëve shpërblimin e dëmit nga Mjeku i Komisionit. Për rastet kur e drejta e përfitimit është dhënë me prapaveprim shpërblimin e dëmit nga Mjeku i Komisionit, Punonjësi Social dhe Përgjegjësi i Komisionit. Kjo në zbatim të pikës 2 të nënit 28 të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në RSH”, i ndryshuar dhe të pikës 17, shkronja (c) të Vendimit nr. 257, datë 05.05.2021, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale.

- Në 2 dosje diagnoza është hedhur gabim në sistem, pasi tjetër diagnozë ka shënuar mjeku specialist në formular dhe tjetër diagnozë është hedhur në sistem.

*Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtoritë Rajonale në lidhje me detyrimet që ka Mjeku i zyrës së Vlerësimit Biopsikosocial, i cili duhet të verifikojë dokumentacionin mjekësor të aplikantëve që në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, të hedhë në sistem diagnozën e saktë ashtu siç e ka plotësuar mjeku specialist dhe për rastet jashtë kriterëve të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Biopsikosocial të mos kryejnë procedurën e vlerësimit. DRSHSSH të njoftojë zyrtarisht aplikantin.*

- Nga kontrolli i afateve të vlerësimit të 2.440 dosjeve rezulton se janë shkelur afatet e komisionimit për 18 aplikant, kjo në kundërshtim me VKM-në nr.722, datë 11.11.2019, i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d: Stafi i zyrës së vlerësimit organizon kryerjen e intervistës, sipas formatit 6, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentave të aplikimit.

*Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtoritë Rajonale në lidhje me detyrimet që ka Zyra e Vlerësimit me zbatimin e VKM-së nr.722, datë 11.11.2019 i ndryshuar, Kreu III, pika 4, gërma d: ku stafi i zyrës së vlerësimit organizon dhe kryen intervistën brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentave të aplikimit.*

- Nga verifikimet e kryera në regjistrin elektronik kombëtar rezultoi se 15 aplikantë nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor pranë KSHVAK-ve.
- **Për 163 rastet e konstatuara me parregullsi në dokumentacion** është lënë detyrë të bëhet rivlerësimi nga KSHA në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

*Grupi i kontrollit ka lënë detyrë të rivlerësohen nga KSHA bazuar në pikën (dh) të Urdhrit nr. 141, datë 19.03.2025 “Për kontrollin e skemës së vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar.*

### **Sfida në skemën NE & PAK**

- Familje në skemë për një periudhë më shumë se 5 vjet;
- Përditësimi dhe plotësimi me saktësi i formularëve të aplikimit nga administratorët shoqërorë;
- Verifikimet social-ekonomike për hyrjet e reja nga DRSHSSH /administratorët shoqërorë;
- Deklarimi 3 mujor/TIMS;
- Fuqizimi i familjeve përmes punësimit dhe shërbimeve të tjera;



- Trajtimi i familjeve me 6% (konstant i pandryshueshëm);
- Vlerësimi i pranueshmërisë për familjet me të ardhura të deklaruar;
- Vlerësimi i KSHVAK – rritja e performancës në vlerësim.

## II. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PAK

Objekti kryesor është respektimi i legjislacionit dhe kriterëve mjekësorë gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK, si dhe marrja e shërbimit në kohë e pa vonesa. Aktiviteti i kësaj drejtorie është ndjekja e ecurisë së komisionimeve sipas modelit Biopsikosocial dhe ecuria e KMCAP-eve të Nivelit të Parë dhe Epror për komisionimin e personave të cilët kërkojnë përfitimin e statuseve të para- tetrapegjisë dhe verbërisë.

### 2.1 Të dhëna të përgjithshme

Të dhënat për përfituesit nga skemat e AK janë si më poshtë:

| Viti | PAK   | Kujdestarë | PTP  | Kujdestarë | Të verbër | Kujdestarë |
|------|-------|------------|------|------------|-----------|------------|
| 2024 | 54056 | 9276       | 5712 | 5652       | 13791     | 3645       |
| 2025 | 57030 | 10081      | 5710 | 5671       | 15303     | 3890       |

Siç vihet re dhe nga të dhënat ka rritje në numrin e përfituesve të PAK dhe atyre të statusit të të verbrit.

### 2.2 Vlerësimi biopsikosocial

Në 37 KSHVAK-ë në të gjithë vendin janë vlerësuar si më poshtë:

| Total | Refuzuar | Përfitues | Nivelet e përfitimit |            |         |                  | Kujdestar |          |
|-------|----------|-----------|----------------------|------------|---------|------------------|-----------|----------|
|       |          |           | I lehtë              | I moderuar | I rëndë | I thellë/I plotë | Niveli 3  | Niveli 4 |
| 53815 | 1384     | 52431     | 11252                | 33278      | 7756    | 145              | 3841      | 800      |


Për periudhën janar – dhjetor 2025 numri i rasteve komisionuar për herë të parë në total për të gjitha qarqet është 5661, numri më i madh i rasteve për herë të parë është nga diagnozat psikiatrike.

#### 2.2.1 Rekomandimet për shërbime

Nga komisionet biopsikosociale për periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë rekomanduar shërbime të ndryshme (fizioterapi, logopedi, këshillim/psikoterapi etj.), të punësimit/formimit profesional dhe arsimit sipas tabelës më poshtë.

| Shërbime Sociale | Arsim | Punësim |
|------------------|-------|---------|
| 13768            | 1284  | 1707    |

Edhe pse KSHVAK-të rekomandojnë marrjen e shërbimeve të ndryshme, problem mbetet ende dhënia e shërbimeve dhe raportimi nga ana e bashkive. Pjesa më e madhe e bashkive kanë mungesë shërbimesh.



## 2.2.2 Komisionet e Shqyrtimit të Ankesave

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, janë ngritur 3 komisione të shqyrtimit të ankesave nga të cilët janë rivlerësuar 2163 individë. 1977 kanë ankimuar vendimet e marra nga KSHVAK, ndërsa 186 janë sjellë për rivlerësim në KSHA nga kontrollat e ushtruara nga grupi i kontrollit në SHSHS. Krahësuar me vitin e kaluar ka ulje të konsiderueshme të ankimimeve.

## 2.3 Statuset e para-tetraplegjisë dhe verbërisë

Për vlerësimin e personave që kërkojnë përfitimin e statusit të para-tetraplegjisë dhe të të verbërit janë dy komisione në nivelin e parë dhe dy komisione në nivelin Epror (1 komision për vlerësimin e statusit të para-tetraplegjisë dhe 1 komision për vlerësimin e statusit të të verbërit). Komisionet si në nivelin e parë ashtu dhe në KMCAP Epror kanë në përbërjen e tyre mjek specialistë të fushave përkatëse, mjek përfaqësues të SHSSH dhe 1 jurist.

### 2.3.1 Statusi i të verbërit

KMPV nivel i parë ka vlerësuar dokumentacionin për 4510 individë, me vendimmarrje si më poshtë:

| Dosje të ardhura për komisionim | 2024        | 2025        | Total        |
|---------------------------------|-------------|-------------|--------------|
| Raste për herë të parë          | 1926        | 2446        | 6577         |
| Rikomisionim                    | 2437        | 2497        | 7184         |
| <b>Total</b>                    | <b>4363</b> | <b>4943</b> | <b>13761</b> |

Siç shihet nga grafiku numrin më të madh të rasteve, rreth 50 % e rasteve për herë të parë, i përkasin qarqeve të Elbasanit dhe të Fierit. KMPV nivelit të parë ka vlerësuar dokumentacionin për 4510 individë nga të cilët vendimet kanë qenë si më poshtë:

|                       |      |
|-----------------------|------|
| Përfitues grupi i I   | 418  |
| Përfitues grupi i II  | 2161 |
| Pa grup               | 1137 |
| Vendim me divergjencë | 794  |

KMCAP Epror për përfitimin e statusit të te verbërit ka komisionuar 1410 persona për të cilët vendimet ka qenë si më poshtë:

|                      |      |
|----------------------|------|
| Përfitues grupi i I  | 262  |
| Përfitues grupi i II | 1044 |
| Pa grup              | 104  |

#### **2.4 Statusi i Para – tetraplegjisë**

KMCAP-i nivelit të parë të përfitimit të statusit të para-teraplegjisë ka kryer vlerësimin për 2270 persona për të cilët vendimet ka qenë si më poshtë:

|                                                 |      |
|-------------------------------------------------|------|
| Përfitues i statusit                            | 1968 |
| Përfitues i statusit pa paketë higjienosanitare | 84   |
| Përfitues i PAK                                 | 25   |
| Pa grup                                         | 193  |
| Vendim me divergjencë                           | 425  |

KMCAP-i Epror përfitimit të statusit të para-teraplegjisë ka kryer vlerësimin për 685 persona për të cilët vendimet ka qenë si më poshtë:

|                                                 |     |
|-------------------------------------------------|-----|
| Përfitues i statusit                            | 518 |
| Përfitues i statusit pa paketë higjienosanitare | 32  |
| Përfitues i PAK                                 | 2   |
| Pa grup                                         | 133 |

### **III. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka në fokus të punës së saj zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës. Kjo drejtori për vitin 2025 ka hartuar planin e veprimit me objektiva të matshme. Qëllimi i këtij plani orientues dhe zhvillues është rritja e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël në zbatim të strategjisë së mbrojtjes sociale.

#### ***3.1 Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit të shërbimeve sociale***

Për realizimin e këtij objekti u realizuan aktivitetet e mëposhtme:

- Janë realizuar raporte dhe plane veprimi të ndryshme sipas Strategjive përkatëse:
  - Raportimi mbi realizimin e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në planin e veprimit të strategjisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; moshimin, PAK, viktimat e krimit, dhunën në familje, të miturit në konflikt me ligjin, komunitetit LGBTi etj;
  - Raporti vjetor mbi luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore;
  - Propozime për ngritjen e shërbimeve të reja, konkretisht për moshimin dhe PAK;
  - Propozime për ngritjen e shërbimeve të reja për target grupet në nevojë si të miturit e pashoqëruar, të rinjtë në konflikt me ligjin dhe varësi nga lëndët narkotike;
  - Propozime për Ligjin e Kujdestarisë alternative (pjesë e grupit të punës);
  - Propozime për ndryshimet e ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror (pjesë e grupit të punës);
  - Propozime për ndryshimin e legjislacionit për “Procedurat standarde të veprimit për VT;
  - Propozime për ndryshimin e VKM-së nr. 518, datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private të përkujdesit shoqëror” (pjesë e grupit të punës);
  - Raportim mbi ecurinë e procesit të Deinstitutionalizimit;
  - Propozime për hartimin e “Planit për Garancinë e Fëmijëve”.
- Harta e shërbimeve sociale është përditësuar dhe nga informacioni i marrë nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH rezulton se është zgjeruar me 11 shërbime të reja, kryesisht 3 shërbime për aftësinë e kufizuar, 4 për persona të moshuar dhe 4 shërbime multifunksional kryesisht për fëmijë. Risi është ngritja e shërbimit në bashkinë Pustec dhe Finiq ku nuk kishin asnjë shërbim për banorët e bashkive të tyre;
- Në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Organizatën PNUD dhe Drejtoritë Rajonale të SHSSH ka realizuar “Hartëzimin e shërbimeve Sociale” për vitin 2025. Ky raport është përgatitur mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga Bashkitë e vendit dhe konkretisht mbi:
  - Nga të dhënat mbi shërbimet shoqërore dhe shpërndarja e tyre në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal rezultojnë rreth 439 ofrues të shërbimeve shoqërore;
  - Të dhënat mbi shërbimet sipas llojit, financimit, tipologjisë së shërbimeve dhe grupeve përfituese rezultojnë se fëmijët me AK zënë 21% të shërbimeve dhe përbëjnë grupin me peshën më të madhe, pasuar nga shërbime për të moshuarit me 18%, dhe

- shërbimet për individët dhe familjet në nevojë përbëjnë 16% të shërbimeve;
- Rritje të ndjeshme kanë pësuar edhe shërbimet në familje për të rriturit me AK të cilat nga 6% është rritur në 11%;
  - Në të dhënat mbi shkallën e plotësimit të nevojës për shërbime sipas rajoneve dhe bashkive kryeson Tirana më 23%, ndjekur nga Korça me 19% dhe Shkodra dhe Elbasani të dyja së bashku me 35% të shërbimeve të siguruara. Bashkitë që nuk kanë ngritur shërbime ose kanë vetëm nga 1 shërbim janë Himara, Konispoli, Dropulli, Malësia e Madhe, Hasi, Puka dhe Tropoja.

### **3.2 Zhvillimi i përkujdesjes alternative**

#### **3.2.1 Procesi i Deinstitutionalizimit 2025**

Procesi i deinstitutionalizimit synon të sigurojë që çdo fëmijë të rritet në një mjedis të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës brenda familjes së tij ose në forma alternative të kujdesit me karakter familjar i cili ka filluar në vitin 2020 me hartimin e Planit Kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022.

Komiteti Drejtues për Zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimi me Vendim nr. 1, datë 08.07.2025 vendosi “Moratoriumin për fëmijë 0-2 vjeç për Shtëpitë e foshnjës në Bashkitë Durrës dhe Shkodër”. SHSSH në zbatim të vendimit të Komitetit Drejtues nuk ka akomoduar fëmijë në shtëpitë e fëmijëve të bashkive të mësipërme. Në vitin 2025 u hartua dhe miratua Plani Kombëtar për Transformimin e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijët drejt Shërbimeve Alternative për Fëmijën dhe Familjen 2025-2027. Drejtoria e Shërbimeve Sociale është njohur dhe ka marrë masat për zbatimin e tij sipas përgjegjësive përkatëse.

Gjatë 2025 stafi i IPSH Durrës ka kryer trajnime me temë:

- Menaxhimi i rastit në procesin e ribashkimit të fëmijës me familjen biologjike, realizuar nga organizata Nisna për ndryshim shoqëror “ARSIS”;
- Shërbime sociale mbështetëse për fëmijën dhe familjen, realizuar nga BE, MSHMS, UNICEF dhe World Vision.

Në zbatim të planit të Deinstitutionalizimit, SHSSH ka hartuar strategjinë e komunikimit me qëllim sensibilizimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për parandalimin e institutionalizimit të fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve. Në vijim të saj është hartuar një plan aktivitetesh për kryerjen e fushatave sensibilizuese. Konkretisht janë realizuar fushata në 14 bashki të vendit (Korçë, Dibër, Lushnjë, Divjakë, Patos, Kukës, Elbasan, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, Gjirokastrë, Libohovë, Memaliaj dhe Dropull). Takimet janë realizuar me të gjithë stafet e drejtorive të shërbimeve sociale në bashkitë e sipërcituara ku qëllimi kryesor ishte ndërgjegjësimi publik për procesin dhe shërbimet e reja si Kujdestaria Alternative Profesionale (KAP), shërbimi i emergjencës dhe shërbimet ditore. Në vijim të deinstitutionalizimit u realizuan takime teknike me bashkinë Vlorë dhe Korçë me qëllim avancimin e procesit të transformimit të shërbimit ekzistues rezidenciale në shërbime të integruara komunitare në përputhje me metodologjinë e miratuar të transformimit dhe me modelet e shërbimeve të pilotuara prej pesë vitesh të mbështetura financiarisht nga Fondit Social.

### **3.3 Monitorimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror**

#### **3.3.1 Institucionet e përkujdesit për fëmijë**

- Për vitin 2025 janë realizuar nga sektori i shërbimeve për fëmijë monitorime në institucionet e përkujdesit për fëmijë. Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga monitorimet e mërpashe ka filluar:
  - Rikonstruksioni i plotë i shtëpisë së fëmijës 6-15 vjeç Sarandë me mbështetjen e Fondit Shqiptar të Zhvillimit;
  - Investim në përmirësimin e kushteve dhe godinën e shtëpisë së fëmijës 6-15 vjeç Shkodër, në pajisjet hidrosanitare, dyer, shmangie të lagështirës dhe dysheme me mbështetjen e Projektit “Shpresë për Botën”;
  - Me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm është mundësuar përmirësimi i kushteve në shtëpinë e fëmijës 16-18 vjeç Shkodër;
  - Janë në proces për transformim me shërbime të reja sipas tipologjisë Qendër Shërbimesh Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen dy shtëpitë e fëmijës “Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Vlorë” dhe “Shtëpia e Fëmijës Korçë”;
  - Nga të dhënat e raportuara rezulton se ka shtim të rasteve të fëmijëve të referuar dhe trajtuar në IPSH-të me probleme të shëndetit mendor si çrregullime të sjelljes, ADHD, çrregullime në të nxënë dhe të vëmendjes;
  - Kufizimi i kapaciteteve vjen si rrjedhojë e procesit të transformimit të 4 IPSH-ve për fëmijë të moshës 0-5 vjeç ku edhe nuk pranohen më fëmijë që marrin shërbim rezidencial (Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë) si dhe mbylljes së përkohshme të shtëpisë së fëmijës 6-15 vjeç Sarandë për shkak të rikonstruksionit. Rreth 80% e kapaciteteve në 7 IPSH rezidenciale janë të plotësuara.

#### **3.3.2 Shtëpitë e të moshuarve**

- Gjatë 2025 janë kryer 6 monitorime në IPSH rezidenciale publike për të moshuar. Konkretisht në Fier, Poliçan, Tiranë, Gjirokastrë dhe Shkodër.
- Problematikat e evidentuara janë:
  - Mos zbatim të VKM-së nr. 518/2018 nga bashkia Fier në të gjitha rastet e sistemeve të moshuarve në institucion;
  - Mungesa e rojeve të sigurisë në institucion si Gjirokastrë, Tiranë etj.
  - Ndërhyrje në infranstrukturë si mungesa e një ashensori funksional(Fier, Gjirokastrë dhe Poliçan) dhe sistemeve të alarmit në rast zjarri;
  - Të hidhen dhe menaxhohen nga vetë specialist i IPSH rastet aktuale të cilat marrin shërbim në IPSH dhe nuk paraqiten në sistemin e SHKSH-së;
  - Mungesa e stafit infermior, kujdestarë në përputhje me standardet e shërbimeve;
  - Rritja e kërkesave për sistemim dhe sistemim i të moshuarve me probleme të rënda të shëndetit mendor dhe fizik, duke vështirësuar ofrimin e shërbimit;
  - Kërkesë për trajnime në ofrimin e shërbimeve për moshën e tretë.

### **3.3.3 Qendrat e zhvillimit**

- Gjatë vitit 2025 janë realizuar monitorime në qendra zhvillimi në Vlorë, Korçë dhe Qendrën e Zhvillimit Pëllumbat;
- Problematikat e evidentuara janë:
  - Ndërhyrje në infrastrukturë;
  - Rikthimi në familje të përfituesve për të ulur kohëqëndrimin në institucion;
  - Rishikimi i vendimit të KMCAP-it nga mjeku i institucionit për çdo përfitues;
  - Ka përfitues mbi moshën 21 vjeçare, gjë që sjell humbjen e funksionalitetit të tipologjisë së shërbimit;
  - Lehtësimi i procedurave për përfshirjen e përfituesve në kurse profesionale.

### **3.4 Monitorime të shërbimeve të financuara nga mekanizmi i Fondit Social**

Në përmbushje të përgjegjësisë së përcaktuar në ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 159, datë 20.3.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social”, Drejtoria e Shërbimeve Sociale kreu vlerësimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në 15 qendra/projekte të përkujdesit shoqëror, të cilat janë mbështetur me Fond Social për vitin 2024 për vitin e parë të financimit. Konkretisht:

- Nga këto shërbime kanë përfituar direkt 458 përfitues me AK, 651 përfitues të moshuar dhe 366 përfitues në qendrat multifunksionale;
- 9 shërbime janë për PAK, 5 shërbime janë për të moshuar, 3 shërbime janë multifunksionale ku përfshihen edhe 2 qendra e emergjencës (2 bashki ofrojnë shërbime edhe PAK, edhe për të moshuar);
- Vlerësimi u realizua në:
  - 14 qendra/shërbime publike, ku ofrues dhe administrues është Bashkia;
  - 1 qendër publike, ku ofrues dhe administrues është institucioni i Këshillit të Qarkut;
  - Shërbime jopublike, të ofruara nga OJF bazuar në marrëveshje me institucionin e Këshillit të Bashkisë.
- Për nga lloji i përkujdesit, 15 qendrat/shërbimet e vlerësuara klasifikohen si më poshtë:
  - shërbime të strehimit emergjent;
  - shërbime të përkujdesit ditor dhe gjysmëditor në qendër;
  - 9 shërbime të përkujdesit në banesë;
  - shërbime komunitare/multifunksionale.
- Për vlerësimin e standardeve të përkujdesit të ofruar, në këto qendra/shërbime të përkujdesit, u kontrollua dokumentacioni i përfituesve dhe stafit, lista përfituesish dhe evidenca periodike, plane pune dhe raporte etj.
- U intervistuan drejtues/përgjegjës të shërbimit, punonjës socialë, staf i pranishëm në institucion, si edhe përfitues të shërbimit;
- Për mangësitë e konstatuara u dhanë rekomandime drejtpërdrejtë strukturave përgjegjëse të shërbimit për marrje masash, për secilin rast, për secilën mangësi dhe me afate.



Problematikat evidentuara nga monitorimet:

- Nga monitorimet të kryera mbi shërbimet sociale të financuara nga mekanizmi i Fondit Social u konstatua se shërbimet e ngritura nga bashkitë nuk janë të pajisura me liçencë për ofrimin e shërbimit, por operojnë me Niptin e Bashkisë;
- Nga monitorimet u konstatua se shërbimet rezidenciale ofrohen në përputhje me standardet e miratuara. U konstatua që disa shërbime komunitare/ditore nuk zbatojnë standardet e përkujdesit shoqëror për tipologjinë përkatëse pasi kanë nevojë për trajnime;
- Vlerësohet fakti se nuk rezultoi asnjë qendër/shërbim i konstatuar i pa ngritur apo i mbyllur. Kjo tregon se bashkitë vazhdojnë të kenë një qëndrueshmëri të shërbimeve të ngritura;
- Një pjesë e stafëve kanë mbivendosje rolesh duke ofruar shërbime si për qendrat e ngritura ashtu, edhe për shërbimet e bashkisë në rolin e NJVNR, PMF, koordinator dhune apo specialistët të fushave përkatëse;
- Disa prej shërbimeve të ngritura nga Fondi Social nuk popullojnë Rregjistrin Elektronik të Shërbimeve Shoqërore pasi një pjesë e stafëve duke pasur mbivendosje nuk kuptojnë rolin e tyre ashtu siç është përcaktuar në SHKSH;
- Shumë shërbime të ngritura nga bashkitë nuk kanë kritere të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe kriteret të përcaktuara sipas VKM-së nr. 518/2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;
- Stafet e shërbimeve sociale kanë nevojë për trajnime mbi standardet sipas tipologjitë e shërbimeve që ofrojnë.


### **3.5 Dinamika e IPSH-ve**

#### **3.5.1 Institucionet për të moshuar**

Gjatë vitit 2025 është vënë re se ka një ulje të numrit të të moshuarve të cilët kërkojnë sistemim në IPSH rezidenciale për të moshuar. Pranë SHSSH janë paraqitur 105 kërkesa për sistemim në IPSH për të moshuar. Ndër to, 52 përfitues kanë probleme të rënda të shëndetit mendor. Problemi që sot po hasin institucionet rezidenciale për të moshuar janë të moshuarit që kanë probleme të shëndetit mendor. Pavarësisht diagnozave dhe ashpërsisë së simptomave, shërbimi shëndetësor ofrohet në institucion nga një mjek me kohë të pjesshme dhe kujdestaret e turnit. Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë SHSSH-së ka qenë pjesë e grupit të ngritur nga MSHMS me urdhër nr. 136, datë 17.03.2025 për rishikimin VKM-së nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

Kërkesat e të moshuarve për sistemim dhe sistemimet gjatë vitit 2025 të ndara në muaj janë:

| Muaji   | Numri i kërkesave për sistemim në institucionet rezidenciale për të moshuar | Numri i të moshuarve të komisionuar nga SHSSH |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Janar   | 6                                                                           | 11                                            |
| Shkurt  | 12                                                                          | 11                                            |
| Mars    | 17                                                                          | 13                                            |
| Prill   | 6                                                                           | 8                                             |
| Maj     | 7                                                                           | 9                                             |
| Qershor | 10                                                                          | 11                                            |
| Korrik  | 8                                                                           | 0                                             |
| Gusht   | 6                                                                           | 6                                             |
| Shtator | 11                                                                          | 9                                             |
| Tetor   | 9                                                                           | 9                                             |
| Nëntor  | 6                                                                           | 4                                             |
| Dhjetor | 7                                                                           | 0                                             |
| Total   | 105                                                                         | 91                                            |



Duke krahasuar me vitin 2024 ku kërkesat kanë qenë 111, janë në ulje krahasuar me vitin 2025, ku numri i kërkesave ka qenë 105.

Gjatë vitit 2024, Komisioni Qendror për Vlerësimin e Nevojave të tëtë Moshuarve ka sistemuar 72 të moshuar në IPSH Rezidenciale për të moshuar. Ndërkohë që për vitin 2025 rastet e akomoduara


kanë qenë 91. Pra nga ana e SHSSH-së janë akomoduar një numër më i madh rastesh të moshuarish në nevojë.

### ***3.5.2 Institucionet rezidenciale të përkujdesit për fëmijë***

- Në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë trajtohen:
  - fëmijë jetimë, të braktisur që në lindje;
  - fëmijë që vijnë nga familje me probleme social-ekonomike;
  - fëmijë të shfrytëzuar dhe viktime të dhunës, etj
  - fëmijë të identifikuar në situatë rruge dhe pa përkujdes prindëror me masë mbrojtje nga GTN;

Qëllimi i IPSH rezidenciale për fëmijë është ofrimi i shërbimit në interesin më të lartë të fëmijës në përputhje me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre. Mbi bazën e këtyre parimeve, synimet kryesore të veprimtarisë së IPSH-ve janë:

- Dinamika e fëmijëve në 7 IPSH-të rezidenciale të fëmijëve gjatë vitit është:
  - Në 7 IPSH rezidenciale publike kapaciteti është 194. Numri aktual i fëmijëve është 154. Krahasuar me vitin 2024 kemi ulje të numrit të fëmijëve nga 172 në vitin 2024 si rrjedhojë e zhvillimit dhe nxitjes së shërbimeve me bazë familjen dhe deinstitutionalizimin.
  - Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë pranuar 46 fëmijë në IPSH-të publike, nga këto 26 fëmijë (*18 në IPSH publike dhe 8 në qendra jopublike*) janë raste emergjente të referuar nga GTN-të dhe janë ndjekur procedurat sipas protokolleve të mbrojtjes së fëmijëve deri në vendosje në kujdestari ligjore me vendim gjykate në institucionet përkatëse me ndërmjetësimin e SHSSH. 15 fëmijë janë pranuar me vendim komisioni nga SHSSH. Krahasuar me vitin 2024 kemi ulje të pranimit të fëmijëve nga 61 fëmijë në vitin 2024;
  - Janë rikthyer në familje biologjike 8 fëmijë. Krahasuar me vitin 2024 nuk kemi ndryshim, kjo për shkak të proceseve gjyqësore të zgjatura;
  - Janë birësuar 15 fëmijë dhe janë në proces 19 fëmijë;
  - 6 fëmijë/ të rinj janë integruar në jetë të pavarur nga Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç dhe 16-18 vjeç;
  - Janë transferuar 21 fëmijë;
  - Janë vendosur në kujdestari brenda familjes 3 fëmijë;
  - Fëmijë në kujdestari ligjore me vendim gjykate në institucione rezidenciale janë 87 fëmijë;
  - Fëmijë nga komuniteti rom 81 fëmijë dhe komuniteti egjiptian 40 fëmijë;
  - Fëmijë të braktisur që në lindje në maternitet dhe të referuar në SHSSH janë 8 fëmijë, krahasuar me vitin 2024 braktisjet në maternitet kanë ulje rreth 50%, 15 fëmijë vitin e kaluar, kjo si rrjedhojë e shërbimeve parandaluese të braktisjes së fëmijëve në kuadër të procesit të deinstitutionalizimit;
  - Janë ndjekur 27 seanca gjyqësore si palë e tretë për çështjet e lidhura me masën e mbrojtjes dhe kujdestarinë e fëmijëve.



### 3.5.3 Statusi i jetimit

Bazuar në ligjin nr.8153, datë 31.10.1996 “Për Statusin e Jetimit” përcaktohet se “përfitojnë statusin e jetimit personat me moshë 0-25 vjeç, që kanë kaluar ose jo nëpër institucione shtetërore a private të përkujdesit shoqëror dhe që plotësojnë këto kriteret:

- Të lindurit jashtë martese;
- Kanë ndërruar jetë të dy prindërit;
- Fëmijë të cilëve me vendim të formës së prerë të gjyaktës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton më;
- Fëmijë që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.

#### ▪ Lidhur me Statusin e Jetimit:


- Kanë kërkuar dhe kanë përfituar këtë status 294 persona nga të cilët 22 persona nuk i kanë të dy prindërit, 272 persona janë të lindur jashtë martese dhe janë rinovuar rreth 950 statute jetimi;
- Krahasur me vitin 2024 ka rritje të kërkesave për përfitim të statusit të jetimit që plotësojnë kriterin fëmijë/i ri i lindur jashtë martese;
- Ka nisur funksionimi online i aplikimeve të statusit të jetimit në sistemin elektronik AMS dhe SQDNE. Gjithsej kanë aplikuar për këtë shërbim 63 raste;
- Në total numri i gjithë përfituesve të Statusit të Jetimit deri në periudhën Dhjetor 2025 është 1350 individë, të cilët përfitojnë pagësën e NE (Ndihmës Ekonomike).

### 3.5.4 Qendrat e zhvillimit për PAK

- Aktualisht në 6 qendrat e zhvillimit për PAK marrin shërbime 213 përfitues, nga të cilët 175 persona mbi moshën 21 vjeç dhe 38 janë fëmijë (0-18 vjeç), kjo për arsye nga më të ndryshme si: braktisja e personave që në lindje, probleme social-ekonomike shumë të theksuara në familje,

prindërit janë shumë të moshuar si dhe me probleme shëndetësore fizike, mendore dhe e kanë të pamundur të kujdesen për fëmijët;

- Ka një rritje numri i përfituesve në qendrat e zhvillimit krahasuar me vitin 2024, ku kanë qenë 198 përfitues. Rritja e numrit të përfituesve në qendrat e zhvillimit ka ardhur edhe për faktin që në IPSH janë futur edhe raste të vështira që nuk janë menaxhuar nga bashkitë përkatëse;
- Një pjesë e përfituesve janë të braktisur nga familjarët dhe kjo ka sjellë që në qendrat e zhvillimit nuk kemi asnjë dalje nga institucioni apo rikthim në familje;
- Qendrat e zhvillimit në Korçë, Shkodër dhe Berat kanë humbur funksionalitetin e tyre, për këtë tipologji shërbimi, pasi përfituesit janë mbi moshën 21 vjeçare dhe nuk mund të marrin asnjë zhvillim për riaftësim jetësor për shkak të diagnozës. Shërbimet që ofrohen në këto qendra janë të përqëndruara më shumë në shërbime bazike si: ushqim, veshmbathje, shërbim shëndetësor etj.. Në këtë kontekst, propozohet ndryshimi i tipologjisë së shërbimit në këto institucione, kjo për shkak të rritjes së numrit të kërkesave pranë SHSSH, për sistemim të PAK mbi 21 vjeç, të cilët janë të braktisur nga familja apo kanë arsye social-ekonomike.



Nga të dhënat e raportuar theksohet kapaciteti i plotësuar 99 % i 6 IPSH-ve për PAK. Në SHSSH referohen gjithnjë e më shumë kërkesa për sistemim në qendrat e zhvillimit për PAK, të rasteve me AK mbi moshën 21 vjeç.

### 3.5.5 Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit

QKPVT është institucion kombëtar i sigurisë së lartë, që ofron shërbimin për strehim, rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të trafikimit, vendas dhe të huaj.

Gjatë vitit 2025:

- Janë asistuar 18 raste (16 viktima të mundshme trafikimi dhe 2 viktima trafikimi);
- 18 viktimat e trafikimit/në rrezik trafikimi kanë kombësi shqiptare (5) dhe të huaj (13);
- Nga pikëpamja gjinore janë 15 meshkuj/ 3 femra;

- Nga pikëpamja moshore 4 janë minorenë dhe 14 të rritur;
- Totali i rasteve të larguara për 2025 është 16.

### ***Problematikat e evidentuara gjatë vitit 2025 mbi çështjet e trafikimit janë:***

- Referimi i rasteve me probleme të shëndetit mendor, të pa trajtuar më parë për një periudhë relativisht të gjatë;
- Identifikim jo i duhur nga strukturat përkatëse lidhur me dhënien e statusit të viktimës;
- Akomodimi i rasteve, ku njëkohësisht janë me status VMT/VT dhe po ashtu janë persona në cilësinë e të akuzuarve, me masa shtrënguese si “arrest shtëpie”, “hetim në gjendje të lirë”;
- Aplikimi për lejet e qëndrimit, nga ana institucionale bëhet në kohë, por janë evidentuar vonesa për paisje me leje dhe përcaktimin e afateve shumë të shkurtra kohore periodike;
- Akomodimi i rasteve të mitur, në konflikt me ligjin, të identifikuar si VMT/VT;
- Pamundësinë e regjistrimit të rasteve me shtetësi të huaj në kurset profesionale, pasi procesi i regjistrimit kryhet përmes platformës e-Albania, në të cilën këto raste nuk kanë akses;
- Kthimi vullnetar i rasteve me shtetësi të huaj, me shpenzime, kursime personale dhe jo të asistuar nga institucionet që merren me procedura financiare, pasi rastet e trajtuara vijnë nga vendi i tyre i origjinës në situatë lufte.

### ***3.5.6 Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje***

Në QKTVDHF gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë trajtuar 40 banorë, nga të cilët 14 gra dhe 26 fëmijë, nga të cilët 8 banorë kanë qenë të mitur të pashoqëruar, ndërkohë që për vitin 2024 janë trajtuar 51 banorë nga të cilët 18 gra dhe 33 fëmijë. Pra, ka një rënie të numrit të rasteve të akomoduara në qendër.

Në vitin 2025 janë integruar 5 banorë së bashku me fëmijët e tyre të cilat janë mbështetur me pagesë qiraje nga OJF të ndryshme.

### ***3.5.7 Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës***

Qëllimi i QKTE është ofrimi i strehimit dhe shërbimeve bazë për personat apo familjet që kanë nevojë emergjente dhe strehim për shkak se mbeten të pastrehë dhe detyrohen të jetojnë në rrugë ose që vijnë nga situata e fatkeqësive natyrore. QKTE ka për qëllim rehabilitimin, mirëqenien dhe riintegrimin e këtyre familjeve në shoqëri.

Në Qendrën Tranzitore të Emergjencës aktualisht marrin shërbim 44 familje (41 gra, 40 burra dhe 99 fëmijë, 189 banorë) krahasuar me vitin 2024 ka rritje të kërkesave për sistemim në këtë qendër nga 37 familje të trajtuara për vitin 2024. Pjesa më e madhe e familjeve të strehuara i përket komunitetit rom. Janë pranuar gjatë vitit 9 familje dhe janë integruar në komunitet 2 familje.

### ***3.6 Përmirësimi dhe mirëmbajtja e Regjistrimit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore***

Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (SHKSH), si pjesë e sistemit të integruar të informacionit, mundëson regjistrimin dhe administrimin e të dhënave në nivel Bashkie,

Qarku dhe kombëtar për kërkuesit dhe përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për çdo tipologji shërbimi, nga referimi i rastit deri në mbylljen e tij. Sistemi ka standardizuar procesin e menaxhimit të rasteve, ruajtje të gjurmueshmërisë, si dhe mundësi për raportim dhe planifikim më të saktë në nivel kombëtar.

### **3.6.1 Arritje dhe përmirësime**

Pavarësisht problematikave, janë evidentuar përparime si më poshtë vijon:

- Deri më tani 61 bashki e njohin sistemin dhe kanë user-a aktiv;
- IPSH-të kanë user-a aktiv dhe kanë nisur popullimin e sistemit;
- Janë realizuar përmirësime në workflow, bazuar në kërkesa dhe sugjerime të SHSSH, duke qartësuar disa hapa të menaxhimit të rastit;
- Monitorimi në kuadër të Fondit Social ka nxitur disa bashki drejt përdorimit më aktiv dhe ka rritur ndërgjegjësimin institucional;
- Janë trajnuar 253 përdorues të sistemit ku fokus të veçantë kanë pasur userat e IPSH-ve.

### **3.6.3 Problematikat e evidentuara**

Monitorimi i sistemit evidenton disa problematika të përsëritura që ndikojnë drejtpërdrejtë në funksionimin e plotë të workflow-it:

- Mungesa e mirëmbajtjes, duke sjellë shpeshherë që sistemi të dalë jashtë funksionit ose të jetë i mbyllur;
- Mungesë infrastrukture dhe pajisjesh (kompjuterë të vjetër, OS të amortizuar si Windows 7, mungesë skanerësh), që kufizon aksesin dhe ngarkimin e dokumentacionit, sidomos te përdoruesit e institucioneve të përkujdesit shoqëror;
- Monitorim jo i rregullt nga Drejtoritë Rajonale lidhur me popullimin e sistemit, çka ndikon negativisht në përdorimin e tij dhe në përshkrimin e plotë të workflow-it;
- Menaxhim jo i rregullt i përdoruesve (mosraportim i lëvizjeve të stafit), që pengon krijimin e user-ave të rinj dhe deaktivizimin e atyre jofunksionalë;
- Vonesa në mbështetjen teknike (përfshirë gjenerimin e raporteve);
- Mospërshkrim i plotë i workflow -it nga përdoruesit, pavarësisht trajnimeve, duke lënë raste të bllokuara në faza fillestare ose të ndërmjetme;
- Kapacitete të kufizuara dhe mungesë kualifikimi të stafit të dedikuar, që sjell vonesa në trajtimin e rasteve;
- Mungesë e ndërgjegjësimit të përdoruesve të sistemit në lidhje me menaxhimin e rasteve nëpërmjet SHKSH-së;
- Akses i kufizuar dhe mungesë filtrimi sipas datës, që e bën të vështirë nxjerrjen në kohë të informacionit të nevojshëm;
- Mungesa e ndërveprimit ndërmjet sistemeve pengon koordinimin dhe ndarjen e të dhënave.

### **3.7 Shkresat e hartuara për KLSH, Avokatin e Popullit dhe institucione të tjera**

- Gjatë vitit 2025 janë hartuar 18 shkresa drejtuar Avokatit të Popullit lidhur me rekomandimet e lëna;

- Janë hartuar shkresa drejtuar MSHMS për t'i informuar lidhur me problematikat e moshimit dhe propozim për ngritjen e shërbimit të ri për të moshuarit me probleme të shëndetit mendor dhe propozim për rishikimin e VKM-së nr. 518/2018;
- Lidhur me AP mbi Dhunën në Familje dhe Moshimin nga KLSH është raportuar dy herë për çdo tipologji lidhur me realizimin e rekomandimeve.

### **3.8 Sfida**

Shërbimi Social Shtetëror në planin e veprimit për vitin 2025 do të ketë sfidë zbatimin e objektivave si:

- Avancimin e procesit të deinstitutionalizimit;
- Funkcionimin e plotë të SHKSH-së në të gjitha bashkitë e vendit;
- Zbatimin e ligjit nr. 92/2025 “Për Kujdesin Alternativ në Familje në Republikën e Shqipërisë”
- Ngritjen e shërbimeve të reja në zbatim të planeve dhe strategjive kryesisht për PAK, fëmijët, moshuarit.




## IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS

Për vitin 2025 DFS ka pasur disa objektiva si më poshtë:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore;
- Mirë-menaxhimi i aseteve;
- Bonusi i bebes;
- Programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti për gratë e papuna;
- Transparencë e plotë e shpenzimeve;
- Korrupsion zero;
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë;
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror.


Bazuar në raportimin periodik statistikor, më poshtë paraqitet numri i familjeve, pjesë e skemës së NE dhe situata e fondeve për vitet 2024-2025.

*Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike për vitet 2024-2025 (pa përfshirë individët dhe 6%)*



Siç shihet nga grafiku nga viti 2024 me 2025, kemi rënie të numrit të familjeve përfituese të NE.


Grafik nr.2: Krahاسimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve 2024-2025



Tregues: Fondi për familjet pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike për vitet 2024-2025 (pa përfshirë individët dhe 6%).

- Për vitin 2024 4,086,355,710 lekë
- Për vitin 2025 3,799,029,407 lekë

Grafik nr.3: Fondi për familjet pjesë e skemës së NE 2024-2025




Nëse krahasojmë fondin e shpenzuar në 2024 me 2025 referuar familjeve përfituese të NE, shohim që fondi është ulur.

*Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2024-2025 (pa përfshirë kujdestarë)*

- Për vitin 2024 73.559 persona me AK
- Për vitin 2025 76,586 persona me AK

*Grafik nr.4: Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK*




Nga viti 2024 në vitin 2025, numri i personave që përfshihen në pagesën e AK, është rritur me 3.027 persona.

*Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK*

- Për vitin 2024 15,449,087,980 lekë
- Për vitin 2025 17,089,723,704 lekë


*Grafik nr.5: Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK*



Më sipër paraqitet shpenzimi fondeve për personat me AK, dhe në vitin 2025 është rritur fondi në krahasim me vitin 2024.

Më poshtë numri i personave me aftësi të kufizuar gjatë 2025 për secilin qark i krahasuar me vitin 2024.

Grafik nr.6: Krahasimi i numrit të personave me aftësi të kufizuar sipas Qarqeve.




**Shënim:** Analiza vjetore 2025 për statistikën zyrtare paraqitur më lartë, të familjeve në skemën e Ndihmës Ekonomike dhe PAK bazohet në të dhënat vjetore.

#### Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

Tregues: Financimet në lekë nga Buxheti i Shtetit/Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:

- 2024 30,332,520,996 lekë
- 2025 28,329,744,252 lekë

*Grafik: Akordimi i fondeve në total për të gjitha llogaritë për vitet 2024-2025*




Në total realizimi i buxhetit për vitin 2025 ka qenë në masën 99%.

*Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE llogaria 606*

- Për vitin 2024 5,763,983,902 lekë
- Për vitin 2025 5,306,775,379 lekë


*Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE – masë realizimi 98%*



*Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK llogaria 606*

- Për vitin 2024 19,612,354,218 lekë
- Për vitin 2025 18,604,218,419 lekë

*Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK – masë realizimi 99%*




Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

*A. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:*

- 2024        787,063,581 lekë
- 2025        857,191,010 lekë

*Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2024-2025*




Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 99.5%, ky koeficient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

*B. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:*

- 2024 131,269,842 lekë
- 2025 142,585,119 lekë

*Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2024-2025*




Realizimi i fondeve për llogarinë 601 është në masën 99 %, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

*C. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:*

- 2024 363,942,653 lekë
- 2025 360,230,176 lekë

*Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2024-2025*




Realizimi i fondeve për llogarinë 602 është në masën 98.5%, ky koeficient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

*D. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në Bashki e Qarqe është:*

- 2024 275,365,973 lekë
- 2025 347,841,532 lekë


*Grafik: Ecuria e fondeve për financimin e shërb.përk. në Bashki dhe Qarqe*



*E. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:*

- 2024 5,975,061 lekë
- 2025 4126680 lekë


*Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2024-2025- masë realizimi 95%*



*F. Realizimi i fondeve të shpenzuara për programin Gratë e Papuna është:*

- 2024 862,709,760 lekë
- 2025 829,350,720 lekë






Realizimi i fondeve për programin e Grave të Papuna është në masën 99%, ky koefiçient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

*G. Realizimi i fondeve të shpenzuara për Bonusin e Bebes është:*

- 2024 6,565 çeqe me fond 2,200,000,000 lekë
- 2025 4,671 çeqe me fond 1,482,355,000 lekë


*Grafiku: Masa e realizimit është në masën 100%*



*H. Realizimi fondeve të shpenzuara për Ndermarrjet Sociale është:*

- 2024 3,676,903 lekë
- 2025 13,583,848 lekë

*Grafiku :Masa e realizimit për vitin 2025 është në masën 71%*



### ***Problematikat e evidentuara***

- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë nga ana e tyre, sidomos për kontratat e lidhura në mes të vitit, gjë e cila solli djegie të fondeve në fund të vitit 2025;
- Plotësimi i pasaktë i formularëve statistikorë të dërguar pranë SHSSH nga Drejtoritë Rajonale, sjell vështirësi nga ana jonë për mbylljen e analizave statistikore periodike në afatin e duhur, duke na detyruar të kërkojmë informacion shtesë;
- Mungesa e udhëzimit të ri në mbështetje të VKM-së nr.617, datë 20.10.2021 për treguesit statistikorë të NE, PAK dhe Shërbimeve Sociale, sjell mungesën e informacionit të detajuar për monitorimin e plotë të këtyre tre programeve.

### ***Propozime***

- Publikimi i udhëzimit të ri në mbështetje të VKM-së nr.617, datë 20.10.2021 për treguesit statistikorë të NE, PAK dhe Shërbimeve Sociale për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër;
- Unifikimi i formularëve të dërguar për NE, PAK dhe SHS, dërguar në DPSHSSH nga DR;
- Komunikim i vazhdueshëm me Drejtoritë Rajonale, si dhe IPSH mbi fondet e shpenzuara në mënyrë që të evidentohen problematikat dhe të mos ketë djegie të fondeve në fundvit.

## **V. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME**

Misioni i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme (DSHB) është menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore, zbatimi i legjislacionit në fushën e veprimtarisë së SHSSH, ndjekja e ciklit të projekteve dhe garantimi i transparencës dhe komunikimit me publikun.

DSHB përmbush këtë mision përmes tri sektorëve: Sektori i Shërbimeve të Brendshme, Sektori Juridik, Sektori i Projekteve. Veprimtaria e tri sektorëve është bazuar në legjislacionin në fuqi dhe planin e punës së vitit 2025, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

### **I. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME**

Sektori i Shërbimeve të Brendshme ka rol kyç në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe materiale të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH, Drejtorive Rajonale, si dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror në varësi. Ai garanton organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të protokollit dhe arkivës në SHSSH si dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse në funksion të vijueshmërisë dhe efektivitetit të punës.

#### **1. Burimet njerëzore**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 administrimi i burimeve njerëzore është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një fokus i veçantë i është kushtuar ruajtjes së funksionalitetit të strukturës dhe organikës së SHSSH, Drejtorive Rajonale dhe IPSH-ve, administrimit korrekt të marrëdhënieve të punës si dhe garantimit të vijueshmërisë së shërbimeve në të gjitha strukturat.

##### **1.1 Rekrutime, emërimë, lëvizje paralele dhe vende vakante**

Gjatë vitit 2025 janë realizuar procedura rekrutimi për vende vakante në SHSSH, Drejtoritë Rajonale dhe IPSH sipas nevojave të evidentuara nga strukturat përkatëse. Proceset e rekrutimit janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke respektuar të gjitha fazat procedurale nga shpallja e vendeve vakante, pritja dhe shqyrtimi i kandidaturave, vlerësimi nga komisionet përkatëse, zhvillimi i intervistave, njoftimi i kandidatëve dhe shpallja e fituesve.

| Institucionet                               | Numri emërimeve | Lëvizje dhe transferime |
|---------------------------------------------|-----------------|-------------------------|
| <b>Shërbimi Social Shtetëror</b>            | 6               | 4                       |
| <b>Drejtori Rajonale SHSSH</b>              | 127             | 0                       |
| <b>Institucionet e Përkujdesit Shoqëror</b> | 90              | 2                       |
| <b>Total</b>                                | 223             | 6                       |

##### **1.2 Largime nga punës**

Gjatë vitit 2025 janë trajtuar rastet e largimeve nga marrëdhënia e punës duke administruar dokumentacionin përkatës dhe duke realizuar dorëzimin e librezave të punës sipas procedurave. Procesi është zhvilluar në përputhje me Kodin e Punës si dhe është pasqyruar rregullisht në dosjet personale të punonjësve dhe në sistemin HRMIS. Analiza e rasteve të largimit tregon se numri më

i madh i largimeve gjatë vitit 2025 ka ndodhur si pasojë e dorëheqjeve me kërkesë të vetë punonjësve ndërsa rastet e tjera lidhen me dalje në pension dhe masa disiplinore.

| Largime                         | Arsyeja/masa                                                      | Numri |
|---------------------------------|-------------------------------------------------------------------|-------|
| Largime nga marrëdhënia e punës | Dalje në pension                                                  | 4     |
|                                 | Dorëheqje me kërkesë të punonjësit                                | 39    |
|                                 | Përfundim i kontratës                                             | 8     |
|                                 | Masë disiplinore “Largim nga puna”                                | 3     |
| Masa disiplinore/Pezullime      | Vërejtje me shkrim                                                | 26    |
|                                 | Pezullime me kërkesë nga vetë punonësi për përfshirje në zgjedhje | 2     |

### **1.3 Puna e realizuar në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve njerëzore në SHSSH, Rajonale dhe IPSH**

Sektori i Shërbimeve të Brendshme nën asistencën e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme ka ndërmarrë një proces të strukturuar pune për analizimin dhe përmirësimin e kapaciteteve njerëzore në funksion të garantimit të vijueshmërisë së shërbimeve dhe respektimit të standarteve të përkujdesit shoqëror. Në këtë kuadër janë trajtuar në mënyrë të veçantë rishikimi i nevojave për staf me kohë të pjesshme si dhe analiza e strukturave organizative të cilat paraqiten në vijim.

#### **1.3.1 Rishikimi i strukturave organizative dhe propozimet për ndryshime strukturore**

Sektori i Shërbimeve të Brendshme në bashkëpunim me Institucionet e Përkujdesit Shoqëror, Drejtoritë Rajonale dhe strukturat përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme ka punuar për analizimin e nevojave reale për rishikim të strukturave organizative në funksion të garantimit të funksionimit normal të institucioneve dhe respektimit të standarteve të shërbimeve sociale.

Numri i punonjësve të propozuar për rritje në strukturat organizative të institucioneve të përkujdesit shoqëror ka qenë rezultat i :

- Numrit të përfituesve;
- Ngarkesës së punës;
- Detyrimeve që rrjedhin nga standardet e miratuara të shërbimeve sociale;
- Rekomandimeve të Avokatit të Popullit;
- Rekomandimeve të Kontrollit të Latë të Shtetit;
- Kërkesave të institucioneve.

Për Institucionet e Përkujdesit Shoqëror janë evidentuar nevoja për profile shtesë si: Mjek, Psikolog, Jurist, Fizioterapist, Infermier.

Po ashtu është kërkuar edhe rritja e numrit të kujdestarëve, sanitareve, magazinierëve dhe kuzhinierëve në përputhje me natyrën e shërbimeve të ofruara. Më konkretisht propozimet për secilën IPSH janë si më posht:

Sa i takon strukturës qendrore të SHSSH dhe Drejtorive Rajonale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe IDRA gjatë vitit 2025 është realizuar rishikimi i strukturave organizative në kuadër të projektit “Rishikimi funksional i Shërbimit Social Shtetëror” duke analizuar funksionet, ngarkesën e punës dhe nevojat reale të strukturave.

## II. SEKTORI JURIDIK

Qëllimi kryesor i punës së Sektorit Juridik është garantimi i ligjshmërisë së veprimtarisë institucionale, përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të institucionit në proceset gjyqësore ku SHSSH ka qenë palë e paditur apo person i tretë, si dhe koordinimi me drejtoritë e tjera të institucionit për zbatimin korrekt të legjislacionit.

### 1. Përfaqësimi i SHSSH në proceset gjyqësore ku është palë e paditur ose person i tretë

Gjatë vitit 2025, Sektori Juridik ka realizuar përfaqësimin e SHSSH në 39 çështje gjyqësore në Gjykatat Administrative dhe Civile të Shkallës së Parë. Për këto çështje janë respektuar afatet ligjore për administrimin e provave, janë hartuar dhe depozituar prapësimet dhe deklaratat e mbrojtjes, si dhe janë përgatitur autorizimet përkatëse për përfaqësimin e institucionit në gjykatat kompetente.

Nga 39 çështje gjyqësore të ndjekura gjatë vitit, 16 prej tyre janë çelur gjatë vitit 2025, dhe çështjet e tjera janë mbartur nga vitet e mëparshme.

| Çështjet Gjyqësore Administrative/Civile ku është palë SHSSH, sipas shkallës së gjykimit |       |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Shkalla e gjykimit                                                                       | Numri |
| <b>Gjykata Administrative/Civile në Shkallën e parë të gjykimit</b>                      | 39    |
| <b>Gjykata Administrative/Civile në Shkallën e dytë të gjykimit</b>                      | 20    |
| <b>Gjykata Administrative/Civile në Shkallën e tretë të gjykimit</b>                     | 10    |
| Totali                                                                                   | 69    |

Analiza e të dhënave tregon se:

- 7 çështje (18%) lidhen me dëmshpërblimin për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës.
- 22 çështje (56%) kanë si objekt shfuqizimin/anulimin e vendimeve të KMCAP-ve dhe/ose Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA-së).

- 5 çështje (13%) kanë si objekt njohjen dhe pagimin e përfitimeve për shkak të statusit të të verbërit.
- 2 çështje (5%) kanë si objekt përfitime të tjera sociale (bonus bebesh dhe pagesë kujdestarie për persona me aftësi të kufizuar).
- 3 çështje (8%) kanë si objekt konstatimin e paligjshmërisë/pavlefshmërisë absolute të veprimeve të tjera administrative, të lidhura me marrjen e posedimit dhe administrimin e objekteve: Godina nr. 1 (3 kate + 1 kat nëntokë), Godina nr. 3 (6 kate + 1 kat nëntokë), të konfiskuara për interes publik, me adresë në Njësinë Administrative Golem, Bashkia Kavajë, ku aktualisht ofron shërbime Qendra e Zhvillimit Tiranë.

Nga 39 çështje që janë ndjekur pranë Gjykatave Administrative/Civile të Shkallës së Parë, 27 prej tyre janë ende në proces. Janë marr vendime për 12 çështje gjyqësore si vijon:

- Nga këto, në dy prej çështjeve që kanë si objekt shfuqizimin/anulimin e vendimeve të KMCAP-ve ose KSHA-së, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur kthimin e padisë dhe akteve shoqëruese.
- Nga këto, në gjashtë prej çështjeve Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë kanë vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.
- Nga këto, në tre prej çështjeve që kanë si objekt dëmshpërblimin për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës Gjykatat e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Dibër kanë vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë duke ulur masën e përfitimit të kërkuar.
- Në një prej çështjeve është vendosur pushimi i gjykimit.

| <i>Vendimet e Gjykatave në shkallë të parë</i> | <i>Numri i çështjeve</i> |
|------------------------------------------------|--------------------------|
| <i>Rrëzuar kërkesë/padi</i>                    | 6                        |
| <i>Pranim i pjesshëm i kërkesës/padisë</i>     | 3                        |
| <i>Pushim Gjykimi</i>                          | 1                        |
| <i>Kthyer padia dhe aktet</i>                  | 2                        |
| <i>Totali</i>                                  | 12                       |

Gjatë vitit 2025, janë mbyllur me vendim nga Gjykata e Lartë dy (2) çështje gjyqësore. Konkretisht, Gjykata e Lartë, në dy raste që kanë pasur si objekt dëmshpërblimin për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës, ka vendosur mospranimin e rekursit të palës paditëse në një rast dhe mospranimin e rekursit të palës paditëse dhe të SHSSH-së në rastin tjetër, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

#### **Gjatë vitit 2025 janë hartuar:**

- 3 (tre) kërkesa ankimore ndaj vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

- 1 (një) ankim i veçantë ndaj vendimit të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm;
- 3 (tre) kërkesa ankimore ndaj vendimeve të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnje.
- 1 (një) draft rekurs, i cili është dërguar së bashku me praktikën përkatëse pranë Avokaturës së Shtetit, në zbatim të procedurave ligjore për nënshkrimin e rekursit, në mbështetje të nenit 474 të Kodit të Procedurës Civile.

*(Në këto raste përfshihen edhe vendime të marra gjatë vitit 2024, për të cilat institucioni është vënë në dijeni përmes njoftimit të vendimit gjatë vitit 2025.)*

## **2. Organizimi i mbledhjeve të komisionit për përjashtimin doganor për personat me statusin e para/tetraplegjisë**

Gjatë vitit 2025, sektori juridik ka pajisur me vërtetim për përjashtim nga detyrimet doganore të automjeteve në pronësi të 23 personave me statusin e para/tetraplegjisë.

## **3. Shqyrtimi i kontratave dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit**

Janë lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi nga ana e SHSSH gjatë vitit 2025 më fokus kryesor përmirësimin e shërbimeve dhe mbështetjen e kategorive të ndryshme shoqërore në nevojë si më poshtë:

- Janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e programit financiar të Fondit Social, në përputhje me projektet e miratuara, me 11 (njëmbëdhjetë) bashki përfituese si Bashkia Krujë, Përmet, Vlorë, Pustec, Elbasan, Divjakë, Shijak, Kuçovë, Vorë, Finiq dhe Durrës.
- Në vijim, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi midis SHSSH dhe Caritas Shqiptar, me Fondacionit “One Heart Children” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për çështje me fëmijët, familjet me NE etj.

## **III. SEKTORI I PROJEKTEVE**

Sektori i Projekteve ka si mision përgatitjen e projekteve në përputhje me nevojat e identifikuar dhe sigurimin e transparencës së veprimtarisë së Shërbimit Social Shtetëror. Veprimtaria e Sektorit të Projekteve është e shtrirë në disa drejtime, konkretisht:

- *Ndjekje e ciklit të projekteve;*
- *Zhvillimi i aktiviteteve;*
- *Garantimi i transparencës së institucionit;*
- *Komunikimi me publikun, median, partnerët, strukturat e varësisë etj.*

## **1. Ndjekje e ciklit të projekteve**

### **1.1 Projekti eldEARLY (Mars 2024-Mars 2026)**

Prej Marsit 2024, Sektori i Projekteve, me mbështetjen e programit IADSA II, po zbaton projektin “eldEARLY- Përmirësimi i Sistemit të Përkujdesit për të Moshuarit në Shqipëri” në bashkëpunim me Qendrën ASET, Regione Marche dhe Regione Liguria.

Qëllimi i projektit është të përforcojë veprimet në mbështetje të të moshuarve vulnerabël, për të identifikuar në kohë problematikat që hasin dhe për të përmirësuar sistemin e mirëqenies sociale në Shqipëri. Në kuadër të aktiviteteve të projektit, gjatë vitit 2025 është bërë e mundur ngritja e linjës së gjelbër për të moshuarit, 0800 4042, ku ofrohen shërbimet e këshillimit dhe referimit për kujdes të shtuar shëndetësor. Ky shërbim ofrohet nga punonjës socialë dhe psikologë. Shërbimi i linjës së këshillimit falas është një arritje, pasi nga pandemia globale e Covid19 u pa e nevojshme zhvillimi i formave të reja të shërbimeve alternative për kategoritë në nevojë, për të shmangur vetminë, izolimin, si dhe promovimin e përfshirjes sociale dhe shmangies së institucionalizimit.

Në kuadër të projektit, përveç ngritjes së linjës së këshillimit falas, janë zhvilluar këto aktivitete:

- Raporti mbi situatën sociale të të moshuarve në 61 bashki të vendit;
- Harta e shërbimeve sociale për moshën e tretë në të gjithë Shqipëri;
- Termat e referencës për figurën e re profesionale të operatorit social;
- Manuale të trajnimit për këshillimin në distancë të të moshuarve dhe shërbimin në banesë;
- Trajnime për 350 profesionistë, punonjës socialë dhe psikologë, për linjën e këshillimit dhe shërbimin në banesë;
- Udhëzuesi për identifikimin dhe referimin e rasteve të të moshuarve në nevojë;
- Termat e referencës për asistencën shtëpiake dhe linjën e këshillimit;
- Lançimi i modelit të shërbimit të asistencës shtëpiake;
- Shërbimi i linjës së gjelbër falas 0800 4042;
- Promovimi i linjës së gjelbër përmes video-ve.

## **2. Zhvillimi i aktiviteteve**

Sektori i projekteve angazhohet në realizimin e aktiviteteve në kuadër të ditëve të shënuara. Gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Fushatë ndërgjegjësimi në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas – 8 Mars;
- Aktivitet në kuadër të Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin – 2 Prill;
- Aktivitet në kuadër të Ditës së Fëmijëve – 1 Qershor;
- Retreat i stafit të SHSSH Vlorë 2025
- Fushatë ndërgjegjësimi në kuadër të Ditës Botërore të Moshës së Tretë – 1 Tetor;
- Aktivitet ndërgjegjëses pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës;
- Aktivitete në kuadër të festave të fundvitit në IPSH, nisma “Një kuti, një arsye për të buzëqeshur”



- Vizita në familje në nevojë në të gjithë Shqipërinë në kuadër të festave të fundvitit.

### **3. *Garantimi i transparencës së institucionit***

#### **3.1 *Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Transparencës***

Gjatë vitit 2025, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, SHSSH ka siguruar transparencën e veprimtarisë së tij përmes përditësimit të vazhdueshëm të faqes zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale. Konkretisht:

- Janë publikuar çdo muaj buletinet e donacioneve dhe informative;
- Është përditësuar çdo muaj Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve sipas formatit të miratuar nga Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Janë përditësuar rregullisht, sipas rastit, statistika, lajme, strategji, dokumente etj.
- Është populluar me informacione të gjithë faqja zyrtare e institucionit, pas mbylljes së faqes së mëparshme për shkak të problemeve teknike, për rrjedhojë Moduli i Transparencës është krijuar nga fillimi;
- Është krijuar dhe përditësuar vazhdimisht rubrika OPENDATA sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm për të dhënat e hapura dhe frekuencën e përditësimit të tyre;
- Në kuadër të rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, është hartuar Aneksi 6 mbi të dhënat personale që përpunohen nga institucioni;
- Janë kthyer përgjigje nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit të SHSSH 25 kërkesave për informacion.

#### **3.2 *Marrëdhëniet me median dhe publikun***

Gjatë vitit 2025, Sektori i Projekteve ka realizuar si më poshtë vijon:

- Janë identifikuar dhe trajtuar 31 raste mediatike;
- Janë trajtuar 145 raste në Portalin e Bashkëqeverisjes;
- Janë trajtuar 403 kërkesa/ankesa me e-mail zyrtar;
- Janë kthyer 102 përgjigje në rrjetet sociale zyrtare të SHSSH.